# Shqipëria etnike


E mërkurë 28 tetor 2015 | Viti XV nr 157 | Çmimi 30 L / 1 euro | E pavarur, periodike | www.shqiperia-etnike.com shqiperia_etnike@yahoo.com | English, page 13-14 | Drejtor Sokol Pepushaj




Fati ynë nuk është shkruar për ne, por është shkruar prej nesh!

**OBAMA**



DIVORCI RAMA-META? NUK NDOSH ASGJË DERI MË 2017
Alfred Lela
faqe 4



SHQIPËRIA PLOT DROGË - BOSËT TË LIRË
Sokol Pepushaj
faqe 3



PREZERVATIVI I TRANSPARENCËS
Andi Bejtja
faqe 2



LUTFI DERVISHI
faqe 5

## 10 ngatërresat me fjalën REFORMË

## Dokumenti i CIA-s; Berisha gati te sakrifikoje pavaresine e Kosoves per zgjedhjet e vitit 1996

faqe 15

Shtetet e Bashkuara dhe shërbimet e tyre inteligjente kanë qenë të shqetësuar për mundësinë e shfrytëzimit nga Sali Berisha të çështjes së Kosovës për përfitime politike të brendshme.

Në një dokument të 21 dhjetorit 1995, analizohen zhvillimet në rajon pas Marrëveshjes së Dejtonit, që qetësoi një pjesë të Ballkanit.



## KY VEND KA MARRË FUND, KA NGELUR VETËM ARRATISJA TË VARFRIN S'KANË PARA PËR TË DHËNË RYSHFET SI MAJTAS SI DJATHTAS

faqe 11



## Prokurori amerikan ndjek gjyqin e zyrtarit për korrupsion

faqe 10



Afrim Krasniqi
faqe 6-7

## Vala e ikjes dhe 10 aktet e dramës që po luajmë



Preç Zogaj
faqe 13

## Si ta zgjojmë detin nga gjumi

Shqipëria në detin Adriatik dhe Jon është pak më e vogël se Shqipëria në tokë. Kemi 427 kilometra bregdet. Kemi ultësirën më të madhe bregdetare të mbarë Adriatikut lindor; baseni nga gjiri i Vlorës në derdhjen e Bunës përfaqëson një port natyror gjigant dhe unik; ky det dhe pozicioni gjeografik i kanë dhënë Shqipërisë atributet e Gjibraltarit të Adriatikut. Në këtë konfigurim gjejmë një prej arsyeve themelore pse na kanë copëtuar...

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Nese...



Nëse ne do të ndiqnim shembullin e Maltës, Kushtetuta e së cilës ndalon personat që kanë falimentuar për të kandiduar për deputet…

Nëse do të bënim si danezët dhe nuk do të 'shkruanim' në lista njerëz që kanë kryer ndonjë akt i cili në sytë e publikut e bën atë të padenjë për të qenë deputet!

Nëse do të kërkonim person me reputacion pa të meta siç bën Islanda.

Nëse do të bënim si Peruja ku një person me rekorde kriminale nuk mund të jetë kandidat për deputet.

Nëse, do të ndiqnim shembullin e Meksikës ku për t'u ndaluar kandidimi mjafton të jesh në gjykim për një krim…

Nëse pëlqehen kaq shumë 'të fortët' dhe të ndiqnim shembullin e Lituanisë që i detyron 'garipat' të vendosin në poster informacionin për dënimin e kryer…

Nëse…do të hidhnim sytë te Kirgistani i largët ku njerëzit që kanë bërë dënime nuk mund të garojnë për në Mexhlis.

Nëse do të bënim si Greqia ku personat që kanë një dënim të formës së prerë jo vetëm nuk bëhen deputete, por as që mund të votojnë…

Nëse do të bënim si Koreja ( e Jugut ) ku e humb mandatin e deputetit kur dënohesh për gjoba të larta për …mbushuni me frymë… publikimin e fakteve të rreme!

Nëse Brazilin përveç futbollit do ta pëlqenim edhe për faktin se senatori detyrohet të lërë mandatin për keqpërdorim të fondeve publike apo (mbushuni me frymë dhe matni tensionin) për.., blerje votash!!!

Nëse biznesmenët që e kanë kthyer Kuvendin tonë si dhomë tregtie, do ta dinin që në Kanada e lë mandatin për shkak të falimentimit..

Nëse do të ndiqnim një apo disa nga shembujt e mësipërm, nuk do të kishim nevojë sot për dekriminalizimin.

Nëse nuk do t'i kishim vendosur në listë njerëzit që më shpesh përdorin koburen, rripin e pantallonave apo grushtat se lapsin apo tastierën…

Atëherë pakica e atyre që janë në Kuvend sot do të mbanin kokën lart dhe nuk do të turpëroheshin të thonin se janë.., deputet!

**Lutfi dervishi**

# Prezervativi i transparencës qeveritare

Nga Andi Bejtja

Këtë mesjavë ndodhi "diçka e vogël", por nga ato gjëra të vogla që flasin shumë më shumë se të ashtuquajturat gjëra të mëdha. Për mua personalisht, kjo ngjarje është një nga më të rëndat, që nxjerr në pah më shumë se çdo gjë tjetër raportin që ka kjo qeveri me demokracinë dhe median, por dhe vlerësimin që ka ajo për inteligjencën, jo thjesht të shqiptarëve, por edhe ndaj gjithë pushtetit të katërt, por thjesht dhe vetëm komunist.

Qeveria, partitë, ministritë kanë foltoret e veta, ashtu sikurse dhe opozita. Dhe flasin e përgënjeshtrojnë aq shumë, e gënjejnë po aq shumë, saqë ua kanë sjellë në majë të hundës të gjithë shqiptarëve. Për më tepër,është e vështirë të shpjegosh se çfarë nevoje ka qeveria për një portal të tillë, kur po kalon në muaj mjalti me shumicën e oligarkëve të medias shqiptare dhe vijën editoriale në shumicën e këtyre mediave pothuajse e gatuan vetë. Ashtu sikurse gatuan vetë dhe politikën e shumë në vite, ka bërë dhe një kritikë, vëzhgim të cilit edhe sot nuk i hiqet asnjë presje. "Media shqiptare, – ka thënë dikur ai, po e perifrazoj, – është pasqyruese e së vërtetës të njërës apo tjetrës palë, por nuk është në gjendje t'u servirë shqiptarëve të vërtetën absolute që është vetëm një, që mund të jetë përtej këtyre palëve, por edhe mund t'i përkasë njërës prej palëve".

E pra, në qoftë se si zgjidhje të këtij vëzhgimi realist ka zgjedhur pikërisht këtë portal, ky leksion i zgjuar që ka dhënë për pushtetin që disa media dhe veçanërisht Fatos Lubonja po e kërkon me kohë: me çfarë parash është rikonstruktuar fasada e kryeministrisë dhe a janë bërë tendera për të? Sa janë donacione të huaja dhe sa janë para të oligarkëve? Ose, për shembull, sa persona paguhen me lekët e taksave tona nga qeveria për të sharë online gazetarët apo eksponentët e opozitës, apo, kohë e fundit, dhe LSI-në? Ose ku i gjeti paratë për një'weekend' luksoz x ose y ministër? Ose, fundja, sa kushton ky portal qeveritar që, në mënyrë qesharake, por njëkohësisht



që fatkeqësisht e trajtoi ngjarjen si temë rozë.

Në mesjavë këshilltari i Kryeministrit për median, por jo vetëm për median, doli vetë në një spot online, në të cilin njoftonte për hapjen e një portali qeveritar me titullin "trasparenca.al", një portal që,sipas tij, lindte si nevojë e përgënjeshtrimit të gënjeshtrave të opozitës dhe të disa portaleve online. Një portal që, ashtu si edhe emri, bëhej për hir të transparencës qeveritare. Vetë motivacioni është i pashembullt, i rrezikshëm dhe qesharak në të njëjtën kohë, pikë grumbullimi kooperative e së vërtetës. Një akt as më pak e as më shumë, studiove televizive. Atëherë pse? Ka vetëm një shpjegim, paniku.

Jemi në një kohë kur akuzat dhe skandalet për ministrat socialistë po shtohen nga dita në ditë dhe kur gazetarë pranë qeverisë po deklarojnë hapur se PS-LSI janë në luftë. Edi Rama, me fillimin e shenjave të para të krizës PS-LSI, e pa shumë mirë se në kohën e sotme (fatmirësisht) të jesh në muaj mjalti me oligarkët e kapanoneve televizive, nuk mjafton të kontrollosh pushtetin e katërt që sot shtrihet përtej këtyre kapanoneve. Edi Rama, përveç shumë sulmeve bajate ndaj medias shqiptare e katërt, nuk na paska qenë një leksion demokracie, por një leksion nazizmi.

Pastaj vjen pyetja tjetër: cilin grup synon ky portal? Ministrat, politikanët, anëtarët e opozitës, parlamentin, median? Kjo nuk ka kuptim. Po kë ka si objektiv atëherë, publikun shqiptar? Në qoftëse ka publikun, atëherë ky nuk ka nevojë të paguajë taksa për një portal ku të shikojë se si një ministër, për shembull, i kthen përgjigje një entiteti, një mekanizmi shtetëror që shërben pikërisht për të kontrolluar transparencën qeveritare. Publiku ka nevojë të dijë, për shembull, atë dhe naziste, ka marrë përsipër transparencën e qeverisë. Kështu po, ky portal ka kuptim, përndryshe është një pesë me hiç.

Është kriminale që shqiptarët të harxhojnë lekë jo për transparencën, po për prezervativin e transparencës. Se ç'mentalitet, ç'qasje kanë këshilltari dhe Kryeministri për median, transparencën dhe të vërtetën tashmë e kemi të qartë. Mbylleni këtë portal, të paktën kurseni lekët e shqiptarëve.

# Shqipëria plot drogë, bosët të lirë





Aksioni i policisë shqiptare për zbulimin dhe asgjesimin e plantacioneve te Cannabis Sattiva ka vazhduar që nga muaji qershor. Në thuajse gjithë Shqipërinë janë asgjesuar mijëra fidanë çdo ditë dhe në shumë raste edhe drogë e perpunuar e gatshme për treg. Ajo që bie në sy është fakti se përveç ndonjë fshatari me pak rrënjë, asnjë nga bosët e drogës nuk është dënuar nga drejtësia shqiptare. Edhe në rastet kur janë zbuluar laboratorë të përpunimit të drogës, bosët, ata që organizojnë dhe shesin lëndën narkotike nuk bien në duart e drejtësisë. Kapen vetëm peshtit e vegjël, të cilët edhe ata e kalojnë ‘’lumin’’ pa u lagur pas një apo dy seancave gjyqësore. Edhe në zbulimin e laboratorit të drogës ditët e fundit, të ngritur në vilën e 34 vjeçarit Valter Pashollari në Durrës, kështu ngjau. U bë bujë e madhe në media dhe u arrestuan 7 punëtorë, por jo bosi, i zoti i laboratorit. Të arrestuar janë: Iqmet Pashollari 61 vjeç, banues në Durrës; Bejto Kotaj 53 vjeç, banues në Shkodër; Ajet Sulaj 40 vjeç, banues në Tiranë; Festim Xhelilaj 39 vjeç, banues në Tiranë; Pajtim Braçaj 52 vjeç, banues në Tiranë; Qerim Xeka 47 vjeç, banues në Krujë Lutfi Xeka 25 vjeç, banues në Krujë, kurse një 17-vjeçar me inicialet K. X nga Kruja do të ndiqet në gjendje të lirë, pra thjeshtë një mjegullnajë mediatike. Operacioni me emrin e koduar “Koordinata” zbuloi laboratorin ku ndodheshin 700 kg kanabis sativa, gati për t’u përpunuar dhe paketuar, por nuk u arriti as kësaj here të prangoset pronari Valter Pashollari. Kanabisi blihej në treg të lire në veri ose në jug dhe e grumbullonin në laboratorin e tyre për ta përgatitur.

Nga kontrolli i ushtruar në banesën e shtetasit Valter Pashollari 34 vjeç,banues në Durrës, i shpallur në kërkim, i’u gjetën dhe i’u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 700 kg lëndë narkotike e dyshuar e llojit Cannabis Sattiva, një peshore elektronike, një makineri vakumi që shërbente për presimin e lëndës narkotike, 7 automjete dhe 15 aparate celularë të markave të ndryshme. Materialet e kaluara Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë për veprime të mëtejshme për veprën penale”Prodhimi dhe shitja e narkotikëve e kryer në bashkëpunim” dhe”Grup i strukturuar kriminal” parashikuar në nenet 283/2 dhe 333/a të Kodit Penal, duket se ashtu si edhe herë të tjera do jenë thjeshtë një vrimë në ujë, pasi opozita akuzon direkt Ministrin e Brëndshëm si kryetrafikant të drogës. Çmimi i Cannabis Sattiva ka arritur mbi gjysmën e vlerës së tregut europian. Shitet nga 1500 deri 1800 euro kilogrami, çka duket se është pikërisht një strategji e studiuar mire, pasi deri para një viti ku lejohej droga vetëm në zonën e Lazaratit, çmimi varionte 300-400 euro kg. e megjithatë prodhohej një sasi e tillë e llogaritur në të holla me një vlerë rreth 5.5 miliard euro. Në tërë mediat e pavarura po akuzohen ministra dhe trafikantë me lidhje politike se drogën po e përdorin për pasurimin e tyre, se lufta ndaj saj bëhet me aksione dhe e diferencuar. Në kohën e pergatitjes së fidanëve, të mbjedhjes apo sherbimeve nuk tentohet të kapen kultivuesit, ndërsa në fazën e pjekjes, të vjeljes dhe përpunimit kapen me tonelata Cannabis Sattiva dhe sot në burgjet shqiptare numërohen me gishta fshatarët e varfër që vuajnë dënimin, pasi për bosët as që bëhet fjalë të vuajnë dënime.

**Sokol Pepushaj**

# Ish punonjësi i SHISH nëpër labirinthet e errëta të krimit

Periudha postkomuniste, pra nga viti 1991 e ketej ka qene mjaft e erret per popullin shqiptar. Vetem ne tre vjet, nga 1997 deri ne vitin 2000 u pushkatuan pa gjyq rreth 4100 shqiptare te pafajshem pas hapje së qëllimshme të depove të armëve, te cilat kaluan në duar e popullatës. Shteti gjithmone, edhe sot per fat te keq, i ngjan nje mafieje te mireorganizuar, ku larja e hesapeve eshte stimuluar edhe nga te ashtuquajturat Organe te Sigurise se Shtetit. Ministria e Brendshme deri sot ka qene gjithmone politike dhe ne konflikt te hapur me Prokurorine e Pergjithshme. Ketu e ka vene theksin kohet e fundit edhe ambasadori i SHBA –së Donald Lu, i cili kete konflikt dhe keto perplasje po i etiketon si prodhime te korrupsionit, ku shume qeveritare, pushtetare, gjykates e prokurore që jane shume te pasur, megjithese kane pagesa mjaft te uleta ne krahasim me vendet e rajonit. Njerezit e ndershem, specialistet e ekspertet, e kane te pamundur te japin kontributin e tyre edhe ne organet apo sherbimet e shtetit. Njeri prej tyre, Aleksandër Vija, punonjes i Sherbimit Informativ Shqiptar per shume vite, nga viti 2001 deri ne 2006, vetem se punoi me ndershmeri e perkushtim, u kthye ne nje viktimë dhe jeta e tij kaloi nëpër labirinthet e errëta të krimit. U gjet një alibi për ta pushuar nga puna me motivacionin absurd “Shkurtohet vendi i punes”. Zyrtarisht nuk mund te sigurosh se kishte edhe nje verejtje te vetme në punë, por disa ish kolegë të tij të flasin fjalë të mira dhe se grupe të mdryshme të lidhura me krimin dhe terrorin ishin zëmëruar me ish punonjësin e SHISH Vija dhe kishin planifikur ta eleminojnë fizikisht pas ndërhyrjeve për ta pushuar nga puna në vitin 2006. Ai per te siguruar njëfarë imuniteti politik iu bashkua Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, çka është ndoshta një lëvizje e zgjuar, pasi megjithe kërcënatat dhe prapaskenat kriminale, arriti të shpëtoi jetën dhe sot nuk është vrarë si qindra të tjerë. Në Prokurorinë e Shkodrës mësojmë se më 23 qershor 2013, pra në ditën e zgjedhjeve parlamentare, Aleksandër Vija kishte një akuzë të rëndë që si perfaqësues i LSI ishte akuzuar se shpërndante para në shkëmbim të votës për subjektin politik LSI së bashku me shtetasin Samir Kajoshi dhe se policia e kishte arrestuar dhe keqtrajtuar. Pas një hetimi të gjatë, procidimin penal Nr. 760, Prokuroria e Shkodrëa e ka pushuar si te pabazuar në fakte dhe ligj. Por kërcënimet ndaj tij dhe familjes së ish punonjësit të SHISH nuk ndalojnë. Është detyruar të bëjë kallzim penal më datën 07.05. 2015 në ngarkim të shtetasve M. GJ. dhe N. A. të cilët e kishin kërcënuar në banesën e tij, duke i dhunuarfizikisht gruan dhe vajzat e mitura. Kallzimi penal mban numrin 1141, por çështja çuditërisht u pushua, Gjithsesi, ish punonjësi i SHISH po kalon një odise të vërtetë mes kërcënimeve, nderkohë që shteti akuzohet perditë me fakte nga media dhe ndërkombëtarët që bashkëpunon me krimin dhe se korrupsioni është refreni i ditës në shqiperinë postkomuniste.

**Redaksia**

# Refuzon lidhjen, vajza kërcënohet me jetë



Janë të shumta rastet në Shqipëri që vajzat e reja, sidomos studentet janë bërë viktima të bukurisë së tyre dhe këmbënguljes së meshkujve për tu lidhur me to, edhe kur ato kanë refuzuar. Një rast i tillë është edhe ai i Lizabeta Zef Pllumaj, lindur më 28 maj 1996 në fshatin Tamare të Malësisë së Madhe. Ajo ishte studente në shkollën e mesme ‘Don Bosko’ në Shkodër dhe jetonte në Konviktin e Murgeshave me një sjellje shëmbullore. Normalisht që një vajzë e tillë do tërhiqte vëmëndjen e meshkujve, por këtë i ndodh jo e mirë përballja me një djalë të quajtur Klaudio. Më datën 6 maj 2015, ky djalë që ishte i shoqëruar me disa shokë e ka ndaluar në rrugë dhe e ka urdhëruar duke i thënë: “Ti do vish me ne”, por Lizabeta që ishte duke shkuar në konvikt ka kundërshtuar dhe e ka paralajmëruar se do njoftojë policinë. Por djaloshi ka tentuar ta futë forcërisht në makinë. Studentja e “Don Boskos” ka bërtitur me të madhe duke kërkuar ndihmë. Në moment Klaudio ka nxjerrë një thikë duke e kërcënuar se po lëshove zë më shumë, do të të vras. Lizabeta e ka parë se ai ishte i armatosur me armë zjarri në brez, por fatmirësisht në rrugë ishin shokët e shoqet e saj të shkollës duke shkuar nga shkolla në konvikt dhe ai nga nga frika e ka lëshuar vajzën, por duke e kërcënuar se “Nuk guxon të lidhesh me askënd tjetër se ju vras edhe atë edhe ty, si dhe po të dënoncosh unë do të vras dhe ta dish kudo të fshihesh të gjej, pasi unë jam socialist dhe shtetin e kemi tonin”. Ky kërcënim ditën për diell, në mes të qytetit të Shkodrës ka terririzuar edhe studentët e tjerë dëshmitarë okular të ngjarjes. Në pamundësi për të informuar organet policore dhe nga mungesa e besimit, pasi policia në shumicën e rasteve dekonspiron çështjet duke bashkëpunuar me kriminelët, kjo vajzë me disa studentë të tjerë janë ankuar në mirëbesim të plotë tek Zyra e Partisë Demokratike Malësi e Madhe. Ndihma që mund t’i jepte Zyra e Partisë Demokratike ishte “Të mos qëndrosh e vetme për asnjë moment.” pasi sipas tyre ky person ka qëllime të këqia ndaj saj edhe për faktin se ai është deklaruar si socialist dhe ka tentuar ta fusi me forcë në makinë dhe e kërcënuar me thikë.

Dhe studentja Lizabeta Pllumaj ashtu veproi derisa përfundoi shkollën e mesme “Don Bosko”. Por kërcënimet këtij vajze nuk i janë ndarë nëpërmjet thirrjeve anonime në numrin e saj të celularit. Ajo shpresonte se dikur këto kërcënime do kenë një fund, por fatkeqësish ndodhi më keq. Më datën 20 tetor 2015 në fshatin Tamarë të Malësisë së Madhe, pasi ajo blen ca ushqime për njerëzit e shtëpisë, ne qëndër të fshatit, një makinë i ndalon afër dhe dikush pasi ul xhamin e saj e pyet: “Lizabeta je?”. Vajza pa të keq i thotë “Po, unë jam”.

-Ah, ti qënke ajo përkrahësja e Partisë Demokratike, heret e vonë ti do jesh jona, edhe e Partisë Socialiste.

Vajza është terrizuar pasi këta persona nuk i njihte dhe ka tentuar të largohet, por ai që foli doli nga makina dhe ushtroi dhunë fizike mbi të, pastaj kur e ka parë se po afrohen njerëz ka qëlluar dy herë me armë zjarri në ajër dhe e ka qëlluar aq fort me grushe duke e lënë pa ndjenja në mes të fshatit Tamarë të Malësisë së Madhe. Fjalët që kanë dëgjuar fshatarët duke i thënë se: “Do të vijmë prapë, nga ne nuk shpëton”, të bëjnë të mëndosh se edhe ky rast është vazhdim i atij kërcënimi në qytetin e Shkodrës kur ajo vazhdonte shkollën “Don Bosko”.

Fshatarët e Tamarës tashmë janë në dijeni të këtyre kërcënimeve dhe mjaft të terrizuar dhe këto veprime i lidhin me qëllimin se këtë vajzë dikush ka synim ta grabisë dhe ta trafikoi për prostitucion, siç ka ndodhur në mijëra raste këto vitet e fundit.

**Redaksia**

Shqipëria etnike

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Divorci Rama-Meta? Nuk ndodh asgjë deri më 2017







Nga **Alfred Lela**

Koalicionet qeverisëse prishen për ide(ologji) të mëdha ose për inate/interesa të mëdha. Përveç estetikës, asnjë ideal tjetër nuk e ndan dyshen qeverisëse Rama-Meta, kështu që bashkëjetesa e tyre politike do të vazhdojë, edhe pse *sublimja* e njërit jo gjithmonë takon *të mirën* e tjetrit. Fatkeqësisht klasa jonë politike, dhe as kredoja e shoqërisë që i mbështet këto elita, nuk e ka arritur ende pjekurinë që ta ndërtojë ose shkatërrojë një koalicion qeverisës bazuar te një ide (al) apo ide(ologji). I mbetet interesit/sherrit/inatit atëherë barra e një prishjeje eventuale, nëse kjo do të ndodhë.

Në ndërkohën që pritet ngjizja e ideales apo plasja e ujërave të zeza të sherrit, ata të dy, Rama dhe Meta, nuk do të jenë ndërtues të marrëdhënies së tyre dhe as të teksturës së koalicionit apo paktit qeverisës. Do të jenë meremetues dhe me këto mbyllje vrimash dhe amendime të herëpashershme *do e shtyjnë si ta shtyjnë* deri në verën e 2017 kur do të mbahen zgjedhjet e reja të përgjithshme.

Më pak se dy vjet deri atëherë bashkë me kujtesën se koha politike rrjedh shumë më shpejt se koha fizike. Kjo do të thotë se Rama dhe Meta nuk do të jenë aq të padurueshëm për njëri-tjetrin sa ç'duket se janë apo sa ç'duan edhe vetë të japin përshtypjen se janë. Ka, sigurisht, mospajtime mes tyre, të cilat ngritën krye me makinerinë e përbashkët elektorale të zgjedhjeve që sapo shkuan, dhe që me gjasë nuk funksionoi, dhe ndoca tradhti që aleati i madh, me sa dyshohet, i kurdisi më të voglit.

Në prag pret një rikonfigurim i qeverisë, por edhe e shumërrahura reformë në drejtësi. Kushtëzimet e të dyjave janë të forta: Meta do kërkojë edhe më shumë se do jepte në lëshimin e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa Ramës i duhet të shpaketojë paketën anti-Metë, të cilën ua ka paraqitur ndërkombëtarëve para se koalicioni i 1 prillit të kaurdisej me verë e ngjala.

Ndërkombëtarët janë të palumtur me dy gjëra më shumë se me të tjerat: amatorizmin makroekonomik të qeverisë Rama dhe 'profesionalizmin' e llojit *homo corruptus* të LSI. Ambasadorët e Fuqive të Mëdha janë të interesuar në konstituimin e njëfarë Forumi Ekonomik me ekspertë që do të prodhonte *economic policy papers* për qeverinë. Paradoksi fillon pikërisht këtu, tek ekonomia pra, sepse bash në këtë damar të dobët ka filluar ta 'kritikojë qeverinë' edhe LSI.

Këto kritika mund t'i nënshkruhen si zakonisht fabulës *mos e prit degën ku rri vetë*, por partisë së Metës i duhet që të rikonfigurojë një zë të përveçëm, edhe pse pa dalë nga koalicioni. Objektivi është i qartë: të paraqitur e LSI si alternativë për në zgjedhjet e verës 2017. Meta do t'i kërkojë partisë dhe vetes një matje forcash *tek për tek* në parlamentaret e radhës. Është ndoshta e vetmja mundësi e tij për ta çliruar formacionin që drejton nga stigma tashmë e ngulitur e parazitit. Edhe gjasa e kalimit nga forcë parazitare në pushtet në parti opozitare, Metës mund t'i shërbejë si alternativë spastrimi.

Deri në finale, ajo që pëshpëritet në aktet hyrëse, sa në skenë dhe sa në prapaskenë, nuk do të marrë trajtën e një konflikti të hapur dhe ndarës. Ka njerëz shpresëmirë që presin nga Rama aktin e guximit politik të pabërë nga Berisha pas skandalit Prifti-Meta.

Nuk ka për të ndodhur. Rama vetë është futur thellë në ujërat e errëta të mëkateve politike. Siç thoshte një mik i dikurshëm për *Newsweek*, Fred Abrahams, atij i është dashur të bëjë kompromise për të arritur te pushteti. Gërryerjet ama do të fillojnë që tani. Acidi i mosbesimit në marrëdhëniet PS-LSI do ta bëjë punën. Nga kjo mund dhe duhet të përfitojë opozita, jo nga Kepi i Shpresës së Keqe që ofron një pakt i mundshëm me partinë e Metës. Një aleancë e tillë do ta fëlliqte edhe atë pak idealizëm që po mundohet të mbledhë me grushte opozita aktuale.



Republika e Shqiperise
Dhoma e Avokateve
Shkoder.
Av. Florinda Gjonej
Nr, liç, 3822 dhe
NIPT K96803002R

KERKESE

PERPARA: GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR SHKODER!

KERKUES: Pashuk Nikolla, i biri i Kole dhe i Luke, i dt. 08\08\1947, lindur e banues ne Muriqan, Njesia Administrative Ana e Malit, Bashkia Shkoder. Perfaqesuar me prokure te posaçme nga av. Florinda Gjonej , Liç, nr. 3822, Anetare e Dhomes se Avokateve Shkoder.

PERSONA TE TRETE.Zyra Gjendjes Civile Njesia Administrative Ana Malit, Bashkia Shkoder.
Zyra e Gjendjes Civile Shkoder.

OBJEKTI: Shpalljen e zhdukjes se babait te kerkuesit Pashuk Kole Nikolla, te te quajturit Kol Hile Nikolla.
BAZA LIGJORE: Neni 375 - 381 te Kodit te Proçedures Civile.

Zoti Kryetar!!

Kerkuesi Pashuk Nikolla, me cilesine e familjarit me te aferm te babait te tij Kol Hile Nikolla i drejtohet gjykates me objektin e mesiperm.
Sipas dokumentacionit qe disponohet nga kerkuesi, gjyshi i tij i quajturi: Hile Nikolla ka patur ne pronesi para Reformes Agrare, toka are, livadhe etj. Rezulton qe ai te kete vdekur ne dt,06\10\1963 duke lene pas vetes femijet e tij: Mrike, Luke, Loro, Kole dhe Ndreke.

Me çeljen e trashegimise ligjore per te ndjerin gjyshin e tij Hile Nikolla, babai i kerkuesit rezulton te jete i gjalle, ndersa ai ka 67 vite qe eshte zhdukur.

Ne gjendjen civile te kerkuesit dhe gjithe familjes se tij, Kol Hile Nikolla rezulton i gjalle. Kjo perveç çertifikates se gjendjes familjare edhe ne çertifikaten personale te tij te leshuar pak kohe me pare. Kol Nikolla eshte larguar nga Shqiperia ne vitin 1948 duke kaluar kufirin shteteror gjate kryerjes se sherbimit te detyrueshem ushtarak.
Qe nga ajo periudhe nga ana e familjes se tij apo nga ata qe e kane njohur nuk eshte pare dhe nuk eshte degjuar qe te jete gjalle.

Ai eshte martuar civilisht ne dt, 18\08\1946 me nenen e kerkuesit. Ne vitin 1948 kur eshte larguar ai ka lene dy femije te dt, 1945 dhe 1947, bashkeshorten dhe dy prinderit e tij. Te dy prinderit e tij Hile dhe Sate Nikolla kane vdekur respektivisht ne vitet, 1963 dhe 1984, dhe bashkeshortja e tij Luke Nikolla ka vdekur ne vitin 2010.

Duke mos patur rruge tjeter per te vertetuar vdekjen e babait te tij kerkuesi i drejtohet gjykates referuar Kodit civil perkatesisht ne nenet 375-381 qe gjyqesisht te behet shpallja e zhukjes se tij dhe pastaj te proçedohet me shpalljen e vdekjes se Kol Hile Nikolla.

Av. Florinda Gjonej
FLORINDA GJONEJ
LIÇ. 3822



Kerkuesi ka qene vetem 1 vjeç ne kohen kur babai i tij ka kaluar kufirin shteteror. Dhe vetem pak muaj me vone ne dt, 15\04\1949 se bashku me motren 4 vjeçe, nenen, dhe te gjithe familjen e babait jane internuar ne Tepelene dhe Lushnje deri ne 29\12\1954. Me vone jane sjelle ne zonat e veriut.

per keto kerkuesi posedon dokumentacion te nxjere nga organet shteterore. Gjate gjithe kesaj periudhe Kol Nikolla nuk eshte bere i gjalle me asnje lloj njoftimi. Ka te pakten 25 vjet, nese ai mund te ishte gjalle, qe ka patur te gjitha mundesite te kthehej ne Shqiperi pa rrezikuar jeten e tij. Por kjo heshtje totale ben qe femijet e tij te besojne me shume ne vdekjen e tij se sa ne te qenurit i gjalle.

I ndodhur ne keto kushte i kerkohet gjykates qe te caktoje nje seance gjyqesore ne menyre qe te beje te mundur paraqitjen e dokumentave qe posedohen si shkak i largimit te tij nga Shqiperia si dhe te na jape mundesine e paraqitjes para gjykates te deshmitareve te cilet do te deshmojne mbi faktin e largimit dhe moskthimit te tij ne vendlindje.

Duke paraqitur si prova shkresore:
. Certifikate familjare 1950 – 1974 Muriqan regj. 176\67 leshuar ne dt, 12\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Shkoder.
. Certifikate familjare 1974 Muriqan libri nr, 28 fleta 227 leshuar ne dt, 18\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Ana Malit.
. Certifikate martese regj, i Akteve Muriqan Dramosh 24\64 viti 1930 – 1945, leshuar ne dt, 16\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Shkoder.
. Certifikate vdekje e Hile Nikolla Akti nr. 30 dt. 07\09\1963 viti 1963, leshuar ne dt. 12\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Shkoder.
. Certifikate vdekje e Sate Nikolla libri nr. 26 fleta 61 fshati Muriqan, leshuar ne dt, 19\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Ana Malit.
. Certifikate vdekje e Luke Nikolla, RKGJC leshuar ne dt, 17\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Shkoder.
. Certifikate familjare e RKGJC te vitit 2010 leshuar ne dt, 05\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Ana Malit.
. Certifikate familjare e vitit 1950 –1974 Muriqan regj. nr, 176\13, leshuar ne d t, 12\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Shkoder.
. Certifikate personale e Pashuk Nikolla leshuar ne dt, 17\06\2015, nga Zyra e gjendjes civile Ana Malit.
. Certifikate personale e Lize Nikolla leshuar ne dt. 17\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Ana Malit.
. Certifikate personale e Kol Nikolla leshuar ne dt, 19 06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Ana Malit.
. Certifikate e gjendjes familjare e Kol Hil Nikolla, e vitit 1974, libri 28 fleta 227, e leshuar ne dt, 29\06\2015 nga zyra e gjendjes civile Ana Malit.
. Certifikate e gjendjes familjare e kol Hil Nikolla, e vitit 2010, leshuar ne dt, 29\06\2015 nga Zyra e gjendjes civile Komuna Ana Malit.
. Vertetim me nr, 51 te prot. te dt, 19\06\2015 i leshuar nga Komuna Ana Malit dhe Kryetari i fshatit Muriqan.

Kerkuesi Pashuk Nikolla

Perfaqesuar nga
Av. Florinda Gjonej
FLORINDA GJONEJ
LIÇ. 3822

# 10 ngatërresat me fjalën reformë….




Nga **Lutfi Dervishi**

Nëse do të kishte dënim për keqpërdorim të fjalës reformë- jo burgjet e Shqipërisë, por as ato të Rusisë nuk do të kishin kapacitet për të mbajtur fajtorët.

Reformë është fjala më e (sh)përdorur në epokën 25 vjeçare të tranziconit. Por sa më shumë kalojnë vitet aq më shumë rritet abuzimi me "reformën". Edhe në google po ta vendosësh fjalën e gjorë… të dalin menjëherë mbi 10 sugjerime: reformë në drejtësi, reformë në arsim, reformë në bujqësi, reformë në shëndetësi, reformë në ekonomi, reformë sport, reformë zgjedhore, reformë në tatime, reforma e pronësisë, reforma në biznes…etj

Abuzimi me fjalën reformë nis nga aksionet dhe fushatat.

**1. Fushata dhe reforma**

Gjatë muajve të fundit kemi dëgjuar nisjen e shumë fushatave/aksioneve, lojërat e fatit, aksion për ndërtimet pa leje, aksioni antiformalitet etj. Fushatat dhe aksionet si rregull kanë një ditë nisje me shumë bujë dhe shuhen si uji i dalë nga shtrati që kthehet sërish aty ku ishte…

**2. Zbatimi ligjit dhe reforma**

Nëse një njeri nuk pi duhan në ambientin ku nuk lejohet, nëse dikush paguan në rregull faturën e dritave dhe të ujit, nëse dikush nget makinën duke zbatuar rregullat e qarkullimit rrugor, nëse shitësi të jep kuponin tatimor, – këtu kemi të bëjmë me zbatimi ne ligjit. Janë të lavdërueshme dhe të duartrokitshme në çdo kohë, përpjekjet dhe rezultatet e arritura, një pjesë shumë të dukshme, por nuk kemi të bëjmë me reforma. Thjesht po zbatohet ligji dhe këtu nuk po shpikim rrotën.

**3. Seminari dhe reforma**

Janë dhjetëra lajmet që në mënyrë të përsëritur kumtojnë çdo ditë fjalën reformë nga tryezat e seminareve, workshopeve, dhe duket se reforma është një proces që nis në orën 10:00 në hotel Tirana dhe përfundon në 19:30 në edicionin kryesor të lajmeve.

**4. Konferenca e shtypit dhe reforma**

Lexo pikën 3.

**5. Gjobat dhe reforma!**

Projektligji ri për procedurat tatimore ka edhe fjalën burg! Gjobat e larta që si rregull shtojnë korrupsionin, po mendohen si zgjidhje për të mbushur arkën e shtetit! Mjaftojnë dy gjoba dhe një biznes të vogël të mbyllë qepenat për të mos i hapur më! Qëllimi gjobave është të mbushë arkën e shtetit dhe të disiplinojë biznesin e vogël… Por gropat në buxhet, siç e tregojnë edhe shifrat hapen ën dogana dhe tatime! Duke përdorur një metaforë të vjetër, qypat me vaj ikin në dogana dhe ushtria e isnpektorëve vrapon pas kokrrës së ullirit në tezgat e tregut çam!

6. Kasa fiskale dhe reforma!

Për shtatorin për shembull u raportuar një rritje e frikshme e numrit të kuponave tatimorë të lëshuar nga biznesi! Vuuuu, propaganda dhe një togfjalësh që sa herë e dëgjoj më dalin dhëmbët jashtë: 'po bëjmë shtet'!!! E vërteta, janë rritur kuponat, por janë arkëtuar më pak lekë! Tani merre kuponin futet në ujë të zier, lëre 30 minuta dhe jepja si çaj çdo mëngjes drejtoreshës së tatimeve!

**7. Shifrat dhe reformat…**

Mark Tweni thotë se shifrat i kemi në dorë, problem janë faktet!

Ka edhe raste kur shifrat janë kokëfortë: psh për 9 muaj vetëm në Gjermani kanë kërkuar azil 45 mijë shqiptarë! Por edhe për këtë e kemi përgjigjen e gatshme: 'janë shqiptarë që kanë ikur nga Greqia'! Sikur kjo të ishte e vërtetë, nuk do t'i kthenin në Rinas, por në Athinë!

**8. Premtimet nuk janë reformë!**

Premtimet për 300 mijë vende pune, për ulje të çmimit të energjisë, për uljen e TVSH-së për ushqimet, për…. I ka marrë era që në momentin që kanë dalë nga goja! Ajo që të bezdis është deklarimi se ke i hapur 120 mijë vende pune! Se si mund të hapen 120 mijë vende pune, kur ekonomia rritet 1% kjo mbetet misteri më i madh pas UFO-ve, ose biem dakord për shifrën 120 mijë nëse qeveria kërkesën për azil e quan hapje vendi pune!

**9. I fortë me të dobëtin…**

Kemi kryer kaq arrestime, kemi futur në burg kaq persona, kemi ndëshkuar kaq e aq…. E vërteta lakuriqe është se në të gjithë aksionet e nisura janë ndëshkuar të dobëtit, të varfrit, të pamundurit…

**10. Facebook dhe reforma!**

Ka një garë të anëtarëve të qeverisë se kush poston foto dhe grafikët më të mirë! Çdo ditë! Dhe më e bukura kur nisin i bëjnë lajka dhe shpërndajnë postimet e njëri tjetrit…sikur qeveria të kishte në jetën e përditshme të njëjtën përkushtim që ka ndaj realiteti virtual! Atëherë po, fjala Rilindje nuk do të mbetej vetëm fjalë!

**Për herë të parë në këto 20 vjet**

Kjo është shakaja më e madhe që shqiptohet tërë seriozitet! Retorikë që përsëritet kudo, mirë në Kuvend dhe në media, por harrojnë dhe ua thonë edhe të huajve që nuk janë shumë familjarë me estradën politike këtu! Pyetja sot është e thjeshtë: një njeri që shkon në spital, është më mirë sot apo 3 vite më parë? Biznesi ndihet më mirë sot apo 3 vite më parë? Njerëzit kanë më shumë shpresë sot apo tri vite më parë?!

Shtet do të thotë sundim i ligjit për të tërë, rregulla të barabarta, gjykata të pavarura, transparencë, llogaridhënie, media e lirë, dhe institucione të pavarura!

**Po reforma?**

Reforma – ishte loja, – thuhej tek 'Dueli heshtur'!

# Prona problem i pazgjidhur; ka prodhuar konflikte shoqërore dhe mijëra vrasje në 25 vitet e fundit

**Sipas statistikave, në 25 vitet e fundit janë mbi 2000 njerëz të pafajshëm të vrarë vetëm si rrjedhojë e ngatërresave me pronat. Shumë noterë dhe gjyqtarë kanë tjetërsuar pronat e pronarëve të vërtetë, çka ka prodhuar presione, plagosje, vrasje. Në Shqipëri** janë ngritur pa leje rreth 400.000 ndërtesa. Sipas një analize që ka bërë Banka Botërore, afërsisht një e treta e tokës në të cilën janë ndërtuar objektet e paligjshme u përket ndërtuesve, një e treta i përket shtetit dhe një e treta një personi tjetër, pra një katrahurë e vërtetë. Dokumentacioni ligjor as që ekziston dhe në thuajse gjithë rastet konfliktet zgjidhen me force. Ka patur vrasje edhe për një kanal, një mur, një gardh, një rrugë të ngushtë. Edhe rasti në fjalë ku shtetasi Ermal Qemal Kurtoviq, banues në fshatin Shtoj i Vjeter, njësia Rrethina Shkoder, aktualisht i kërcënuar me jetë, është në një konflikt në prag tragjedie. Ky shtetas ka një konflikt prej shumë vitesh pikërisht me djalin e xhaxhait, të quajturin Saimir Mehmeti për një gardh që ndan tokat e dy personazheve. Saimir Mehmeti pretendon se gardhi në fjalë duhet shtyrë më tej pas i kanë tokat ngjitur dhe me vetëgjyqësi i bën presion ta spostojë gardhin për ti liruar më shumë hapësirë, ndërsa Ermal Kurtoviq i thotë se gardhi është në vëndin e vet dhe është i gatshëm ti drejtohen komunës, ligjit e në fund të fundit edhe pleqësisë së fshatit, por pa rezultat. Presionet e herëpashershme kanë degjeneruar në dhunë fizike dhe në kërcënim me jetën ndaj shtetasit Ermal Kurtoviq. Rreth ores 19.00 të dates 17.09.2015 shtetasi Saimir Mehmeti ka shkuar tek toka e shtetasit Ermal Kurtoviq dhe ka tentuar të lëvizë gardhin nga vëndi. Ermal Kurtoviq e ka pare dhe menjëherë ka shkuar të mbrojë pronën e vet duke ngulur këmbë se gardhi aty ka qënë prej shumë kohësh dhe se aty eshtë kufiri i pronës, por kushëriri e ka kërcënuar se "do ta spostoj gardhin don apo nuk don ti, se të takon apo jo ty, se edhe të vras dhe ligjin e bëj vetë". Konflikti ka degjneruar deri sa Saimir Mehmeti ka shkulur një hu, (dru) nga gardhi duke e sulmuar për ta goditur në kokë, duke i thënë se të vras, por fatmirësisht disa kalimtarë të rastit kanë qëlluar afër dhe njëri prej tyre, nga fshati Guci e Re ka ndërhyrë në mes dhe e ka ndaluar një tragjedi që shkak ka një gardh që ndan pronat.

Për ngjarjen është lajmëruar menjëherë Salla Operative e Policisë Shkoder nga i dëmtuari Ermal Kurtoviq, i cili ka depozituar edhe kallëzim penal pranë Policisë Gjyqësore në Sektorin e Parandalimit të Krimeve pranë Komisariatit të Policisë Shkodër. Por pikërisht ky kallëzim penal ka acaruaar edhe më keq situatën. Saimir Mehmeti arrestohet nga policia, por ai kishte te njohur edhe atje dhe pas 24 orëve lirohet. Shumë i acaruar vendos të hakmerret dhe më 20 Shtator 2015 Saimir Mehmeti shkon tek shtëpia e Ermal Kurtoviq dhe e kërcënon me jetë duke nxjerrë pistoletën për të vrarë Ermalin. Babai i Ermalit për të shpëtuar jetën e djalit të vet merr nje thikë dhe e therë Saimir Mehmetin. Kështu situata acarohet edhe më shumë. Që nga ajo ditë familja e Ermal Kurtoviq është në rrezik serioz. Pra një konflikt që vazhdon prej shumë vitesh tani shumë më i tensionuar.

**Redaksia e gazetes**

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.


# Vala e ikjes dhe 10 aktet e dramës që po luajmë

- Nga Afrim Krasniqi -

Të dhënat zyrtare të qeverisë gjermane tregojnë se shqiptarët përbëjnë qytetarët e dytë në listën e emigrantëve përgjatë vitit të fundit. Qeveria gjermane, në të drejtën e saj, vendosi kthimin e tyre masiv, dhe BE e shpalli Shqipërinë si vend i sigurt i origjinës. Prej gati dy muajsh, sipas programimit, avionë me refugjatë ulen në Rinas për tu shpërndarë më pas drejt periferisë. Shpeshherë në pritje të tyre në Rinas gjenden zyrtarë të lartë të Ministrisë së Brendshme, kamera televizive dhe diplomatë të huaj, - të gjithë për të njëjtin qëllim: të dëshmojnë vendosmërinë e kthimit të tyre. Kjo është një prej akteve të pakta publike të dramës më të re të emigrimit shqiptar drejt Evropës. Aktet e tjera të dramës po luhen ende në Tiranë, por jashtë skenës që publiku sheh dhe vlerëson.

Akti i dytë është sjellja e gabuar institucionale me valën e ikjes. Kur disa muaj më parë nisën valët e reja të emigrimit qeveria e majtë tha se po ikin banorët e zonave që kishin votuar për të djathtën ose ishin keq-qeverisur prej saj. Më pas, kur numri u rrit dhe harta u zgjerua në zona të djathta e të majta, qeveria tha se ata janë viktima të dezinformimit dhe grupeve kriminale. Kur një fushatë sensibilizimi dështoi të frenojë valën e ikjes atëherë qeveria ndryshoi qëndrim dhe tha se nuk janë banorë që largohen, por janë emigrantë që vijnë nga Greqia dhe largohen drejt Gjermanisë! Janë tri kohë brenda një kohe, tri alibi brenda një drame dhe tre tregues sesa larg qëndron dhe mbetet politika vendimmarrëse ndaj problematikave lokale, sidomos pjesës më të varfër që përbën edhe bazën kryesore të valës emigruese. Dhe kur nuk ka analizë, nuk ka real-politikë, nuk ka vëmendje dhe as seriozitet, nuk ka as politika që merren me shkaqet e vërteta të emigrimit, dhe për pasojë, me parandalimin e tyre përmes politikave të mira në të ardhmen.

Akti i tretë lidhet me konceptin denigrues ndaj qytetarit në nevojë. Në politikë ka një rregull: forca e shtetit demokratik matet nga kujdesi e respekti ndaj të dobëtit, të varfrit, të braktisurit dhe jo ndaj elitës së vogël që përbën oligarkinë e çdo pushteti. Në rastin shqiptar politika bëri e vijon të bëjë të kundërtën, - me gjithë avionët e mbushur me refugjatë që kthehen nga autoritetet gjermane, ende qeveria dhe asnjë institucion shtetëror nuk ka prezantuar një projekt, plan apo ide konkrete sesi ajo do të përkujdeset ndaj të kthyerve, dyfish më të varfër sesa në largimin e tyre. Zyrtarët që marrin me vete kamera të TV dhe japin deklarime në Rinas, ende nuk kanë bërë as vizitë kortezie në fshatrat e Kukësit apo zonat e tjera të prekura dukshëm nga vala emigruese. Askush nuk i takon, askush nuk i dëgjon, askush nuk u ofron një zgjidhje për një jetë të jetueshme në fshatin apo zonën e tyre, - thjesht shteti e konsideron të mbaruar detyrën e vet duke i pritur si bagazhe në Rinas.

Akti i katërt, lidhet me natyrën denigruese që ne etiketojmë qytetarët që ikin. Në të gjitha ligjërimet politike është thënë se ikja e tyre dëmton imazhin e vendit, dëmton sistemin e liberalizimit të vizave, dëmton raportet e besimit me vendet partnere, etj, etj. Kjo në fakt, është gjysëm e vërtetë, madje pjesa më dytësore e dramës. Gjysma tjetër dhe pjesa kryesore lidhet me trajtimin e valës së emigracionit si faj qytetar dhe jo produkt i gjendjes ku ata ndodhen. Kush e dëmton më shumë imazhin e një vendi, qytetari që ikën për kushte më të mira jetese apo modeli i politikanit dhe zyrtarit që vjedh pasurinë publike, vjedh vota dhe që e bën tiparin e kriminalizimit të politikës headline në axhendat dhe takimet ndërkombëtare? Cili është më përgjegjës, qytetari që thyen ligjin për udhëtimet jashtë vendit, apo zyrtari e politikani që shkel kushtetutën në detyrimin për transparencë, mirëqeverisje, përgjegjësi publike dhe shërbim ndaj qytetarit? Nuk ka vend për ndarje bardh e zi, por ka hapësirë të madhe për një qasje tjetër shumë më të përgjegjshme ndaj fenomenit të varfërisë, të ikjes, të emigrimit apo të standardeve të dyfishta që aplikohen midis pushtetarëve e qytetarëve.



Akti i pestë lidhet me konceptin tonë të qeverisjes vendore dhe shërbimin ndaj qytetarëve. Sapo bëmë zgjed-

hje vendore, zgjodhëm kryetarë bashkish, por në asnjë platformë të tyre dhe as të liderëve politikë që drejtojnë në qendër, nuk kemi parë projekt apo propozime konkrete për zhvillimin rajonal, sidomos më zona "të vdekura" ekonomike, siç janë zonat kryesore të emigrimit. Kur i pyesnim në fushatë, interesi i vetëm i kandidatëve ishte nëse refugjatët ishin votues apo jo, pra si numra votuesish, jo si njerëz, si përgjegjësi dhe si detyrim kujdesi ndaj tyre. Nga ana tjetër, kur lexon buxhetin e ri shtetëror dhe financimet qendrore e lokale nuk gjenden pothuajse asnjë investim serioz që hap vende pune apo garanton shanse angazhimi për qytetarët e kthyer në Rinas, në zonat problematike të emigrimit. Vëmendja kryesore është për qendrat e mëdha urbane, pjesa rurale, sidomos periferia e saj, është jashtë çdo projekti, jashtë buxhetimit dhe jashtë prioritetit.

Akti i gjashtë lidhet me sistemin tonë social. Drama e emigrimit mund të sjellë shumë pasoja. Janë njerëz në borxhe, njerëz në dëshpërim, njerëz në dramë familjare, familje të ndara, fëmijë që braktisin shkollën, ekonomi familjare që nuk mbijeton, etj. Cila është përgjigjja jonë ndaj tyre? Një sistem kreditimi, lehtësimi të taksave, nxitje të investimit të huaj me taksa lehtësuese, rrjet psikologësh dhe mësuesish asistues? As njëra dhe as tjetra. I lëmë në dramën e tyre, u kërkojmë të mos provojnë më të largohen dhe i kërcënojmë me burg nëse tentojnë ikjen ose mospagesën e faturave dhe taksave lokale. Asgjë sociale, asgjë humane, asgjë solidare dhe asgjë shpresëdhënëse.

Akti i shtatë luhet nga vetë shtetet perëndimore, përfshirë shteti gjerman. Pavarësisht kujdesit, ndihmës dhe investime të shumta gjermane në Shqipëri raportimet se 45-55 profesione kërkohet të punësohen atje, pra kanë prioritet emigrimi ndryshe nga pjesa tjetër qytetare, është mesazh i gabuar dhe disi diskriminues për realitetin shqiptar. Së pari sepse në vendin e varfër bëhet oferta për t'i marrë pjesën më të kualifikuar të tij, së dyti sepse krijon dy standarde për të njëjtin fenomen emigrues dhe së treti sepse krijon hapësirë më shumë për spekulantët e trafikantët shqiptarë të diplomave dhe emigrimit. Skena e kursit të infermierëve dhe kapardisja e zyrtarëve tanë të lartë atje, ku në thelb është një kurs për ikjen e infermierëve nga Shqipëria, një vend pa spitale e sistem shëndetësor profesional e funksional, - përbën pikën kulmore të këtij akti.

Akti i tetë luhet nga vetë shoqëria, media dhe publiku. Cila media shkoi tek një familje e kthyer dhe u interesua për mënyrën sesi ata (mbi)jetojnë? Cila OJF apo grup civil asistoi me ndihmë, këshillim, shoqërizim apo informim grupet e prekura nga vala e emigrimit? Cilët qytetarë iu bashkuan nismave për protestë dhe apelim për mirëqeverisje dhe dhënien fund të sistemit të arrogancës dhe klientelës që ende sundon në hierarkinë vertikale të qeverisjes? Cili VIP apo institucion kaloi një fundjavë në zonat e prekura nga emigrimi, qoftë edhe për tu dhënë sinjal se ata nuk janë të braktisur dhe as të huaj në vendin e tyre? Asnjë.

Akti i nëntë lidhet me sistemin gjysmak të imponuar përmes udhëtimit me charter. Në të vërtetë ai nuk është udhëtim me një drejtim. Ata që duan të ikin do kërkojnë forma të tjera dhe përsëri do të ikin. Unë njoh të tillë që kanë provuar disa herë dhe ende janë në kërkim të rrugëve të ikjes. Në mos në Gjermani, diku tjetër, në ishullin britanik apo vende skandinave. Bileta e kthimit është vetëm një hap drejt legalitetit, jo fundi i konsumit të mjeteve shtetërore e politike. Shqipëria zyrtare duhej të kishte sot një skedar qytetarësh të kthyer, një program ri-integrimi të tyre, si dhe një kontakt të përhershëm dhe funksional me secilin prej tyre. Nga ana tjetër fushata e kthimit nuk duhet kurrsesi të paragjykojë dhe indirekt edhe të dëmtojë ata që kanë nevojë udhëtimi për interesa specifikë, siç janë arsimimi, kualifikimi shkencor, kontaktet profesionale, partneriteti i biznesit apo edhe qëllime shëndetësore.

Akti i fundit lidhet me konceptin dhe kulturën tonë të ikjes dhe rënies në depresion. Në historinë tonë valët e ikjes janë të shumta, valët e kthimit janë minimale. Ikja shihet si shpëtim, kur në fakt, është një prej formave që zgjat agoninë. Imagjinoni të ikin të gjithë ata që janë të zhgënjyer, çfarë do të ndodhë? Do mbeten në Tiranë pakica, - ca ministra, ca deputetë, ca partì, ca shefa policie, dogane e tatimesh, ca gjyqtarë e prokurorë, ca drejtues mediash dhe biznesmenë, si dhe familjet e atyre që kanë pushtet. A duke të lejojmë që pakica e lumtur të dëbojë me arrogancën e saj shumicën e zhgënjyer apo të lodhur nga vështirësitë e tranzicionit? Kurrsesi.

Ndaj përpara vendimit për ikje me çdo kusht, le të shohim shanset për opsione të tjera. Duke nisur nga gjëra të vogla, - për shembull, të rrimë më pak në kafene dhe më shumë në punë (cilado qoftë ajo); të shkojmë më pak në mitingje dhe pas liderëve dhe të kujdesemi më shumë për fëmijët në shkollë, për familjen dhe për jetën në komunitetin ku jetojmë; të reagojmë me forma civile kundër çdo padrejtësie, abuzimi, korrupsioni apo përçmimi që vjen nga sunduesit e radhës; të flasim me zë të lartë ndaj fenomeneve negative, dhe ti dëbojmë nga lagjia jonë të gjithë ata politikanë qendrorë e lokalë që vijnë për ta na blerë votat apo që refuzojnë të bëjnë kontratë sociale me premtime konkrete; të zgjerojmë arsimin profesional dhe sistemin e kredive të vogla familjare; ta shohim librin e shkollën si shansin e vetëm për një jetë më të mirë apo edhe të punojmë dhe mbjellim tokat që kemi. Asnjëra prej tyre apo të gjitha së bashku mund të mos jenë receta ideale e zgjidhjes, por me siguri vlejnë dhe janë shumë më tepër sesa ikja, nënshtrimi ndaj fatit, jeta e përulur apo trashëgimia e varfërisë.



U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Letra emocionuese nga burgu e Mandeles shqiptar për mbesen e tij të dashur...

*Nga Pjetër Arbnori*

*Mbesë e dashur!*

Sot bëhen 25 vjet që jam ndarë nga familja/ Ti atëherë nuk kishte lindur, as nëna jote nuk ishte fejuar e martuar, kurse tani je rritur e vazhdon shkollën e mesme. Është kohë provimesh e do të jesh e mbytur në mësime. Unë s'mund të të ndihmoj, por do të tregoj diçka që do ta shtojë vullnetin për të mësuar.

Kur më futën në burg, së pari e kisha me tepri atë që më kishte munguar gjithmonë: kohën. Isha bërë 26 vjeç pa u ngopur një herë me gjumë, pa u kënaqur me asgjë, se gjithnjë sikur dëgjoja dikë që më thoshte: "U bëre vonë! S'ke kohë! Të pret provimi, takimi, puna!" Të gjitha i kisha nxjerrë me mundim në jetë. Tani, përveç andrrallës së madhe, s'kisha halle të tjera. As bukën për të fituar, as probleme të familjes për të zgjidhur. Do të gdhija e të ngrysja mijëra, në mos dhjetëra mijëra ditë me durimin e pikës së ujit që shpon gurin. Duhet të gjeja nj mënyrë për t'i kaluar dobishëm gjithë këto qindra mijëra orë, që të mos lija të më shtypnin me peshën e vet. Ëndërrimi i tepruar të bën melankolik. Po edhe ata që provojnë ta kalojnë burgun me gjumë, nuk bëjnë tjetër veçse ndryshojnë orën e tyre biologjike, flenë ditën dhe vuajnë natën. Po nata ka mendime të këqija, rraskapitëse dhe, përgjithësisht, ata që çrregullojnë gjumin, kanë prirje të parët për t'u çmendur. Punët e tjera, sidomos të larat e të qepurat, s'ta hanë gjithë ditën, sado të bubërrosh. S'mbetet vetëm një rrugë: studimi. Për fat të keq nuk kisha libra dhe nga shtëpia këtu nuk lejoheshin. Veç kësaj, në burg librat artistikë përpihen shpejt dhe s'ka bibliotekë që ta ngopë të burgosurin. Mbasi pata përpirë gazetat e palexuara gjatë dy vjetëve të fundit, kur isha shkëputur nga jeta, solla sytë se mos gjeja diçka tjetër për të studiuar. Të burgosurit që kisha në dhomë s'më vinin dot në ndihmë. Kisha një kamerier, një bujk, një murator, një oficer, një brigadier, një çoban, një llogaritar dhe një ambasador, të gjithë me nga një "ish" përpara. Vetëm oficeri më dha 4 vëllimet e romanit "Lufta dhe Paqja" të L. Tolstoit, libër i mrekullueshëm, që e kisha lexuar në rusisht, e vetmja gjuhë që dija kur isha i lirë. Që në faqet e para ndesha në bisedat që shkëmbenin frëngjisht konteshat e princeshat, siç ishte zakon i aristokracisë ruse të shek XIX.

Ndala leximin e po mendoja: Po sikur t'i mësoj disa fjalë frënge! Gjuha e huaj është puna më e dobishme dhe të cilën kalon kohën pa u ndier. Po me se të studioja kur nuk kisha një metodë, asnjë gramatikë, asnjë fjalor? Çobani dinte vetëm vllahçe, bujku e llogaritari dinin një greqishte të përdhosur. Kisha ngrirë me "Luftën e Paqen" në dorë. Mora një fletore dhe nisa të kopjoj rresht për rresht dialogët e shtypur në frëngjisht bashkë me përkthimin e dhënë në shqip. Më dolën, në mos gabohem, rreth 16 faqe të mira, duke përfshirë aty edhe letrat e Julisë, të Napoleonit apo Carit. Kur e kisha lexuar para disa vjetësh në origjinal, qeshë bezdisur nga gjithë ato shprehje frëngjisht, të dhëna edhe rusisht, me shkronja të vogla. Ç'nevojë ka pasur për këtë formalitet,- ankohesha atëherë me vete kundër Tolstoit. Tani po i shikoja me sy tjetër. E qortoja Tolstoin përse nuk kish futur edhe disa faqe më tepër frëngjisht. Sepse kjo ishte pasuria e vetme e frëngjishtes. Caktova tri fletore për fonetikën, për gramatikën dhe për fjalorin. Si do të mësoja pa ndihmën e asnjeriut?! Vërtetë shkollën e lartë e kisha kryer pa ndihmën e askujt, pa dëgjuar asnjë leksion, mirëpo, kisha librat. Këtu ishte ndryshe. Në bisedë, ambasadori më kishte thënë se kishte bërë metodat e frëngjishtes, por kur ia hodha fjalën largas, për ndonjë ndihmë, e bëri veshin shurdhër. E dija që frëngjishtja nuk lexohej ashtu siç shkruhej dhe ky ishte një telash i madh për mua.



Kur isha 11 vjeç, më 1946, na patën vënë në programin shkollor gjuhën frënge. Mësues kishim Hydajet Cenkën. E patëm marrë me qejf si unë, si Margarita[2]. Gjithë ditën cicëronim fjalët e para në frëngjisht. Patëm bërë 7 a 8 mësime, por pas pak javësh na e hoqën. Ishte një kohë kur programet e gjuhëve të huaja ndryshonin me muaj, derisa përfundimisht u vu rusishtja, pak gjë mbaja mend nga ajo kohë. Diçka tjetër më erdhi ndër mend jrejt papritur. Kisha në kujtesë me qindra emra gjeografikë apo emra shkrimtarësh francezë. I mbaja mend se si shkruheshin, por edhe se si lexoheshin. Nisa pra, e i shënova si më vinin ndër mend: Bordeaux = Bordo, Voltaire = Volter etj. Filluan analizat e mundimshme fonetike së bashku me pikëpyetjet e para. Kështu, duke studiuar për shumë ditë e net qindra emra të përveçëm unë i nxora qindra 'rregulla' të fonetikës së frëngjishtes, deri në shterim. Kur e mbusha fletoren me gjithë ato ligje, nisa ballafaqimin e tyre. Kuptohet se frëngjishtja duhet të ishte shumë më e thjeshtë nga ç'më dilte mua dhe për këtë po përpiqesha edhe unë. Dhe inatosesha me vete për tri a katër tabela që më mungonin, më duhej të rropatesha ditë e net të tëra për t'i kodifikuar vetë dhe me gjithë mundin e djersën e derdhur, isha i ndërgjegjshëm për zbrazëtitë e krijuara.

Në çdo tre-katër shënime ngrihej kërcënuese një pikëpyetje e madhe e shënuar me të kuqe. Dhe kur arrija ta zhdukja njërën, më dilnin sërish dy të tjera. Kur m'u duk se mbarova punë me fonetikën, mora frymë i lehtësuar. Rrëmbeva atëherë fletoren me tekste frëngjisht dhe në orën e ajrimit nisa të lexoj në oborr me zë, në bazë të rregullave që kisha nxjerrë. Më vinte mirë që nuk dëgjonte ndonjë që e dinte frëngjishten se me siguri do të më shikonte i habitur për të më kuptuar se në cilën "gjuhë afrikane" po bëja ushtrimin. Ish-ambasadori më pati thënë në fillim se kishte bërë frëngjisht e rusisht. Po ai më tha se dinte fare pak, madje edhe atë që e kishte mësuar, tani e kishte harruar. Ndërsa në frëngjisht më tha se mbante mend më mirë. Që kur kisha nisur të mësoja, ambasadori më shikonte si me çudi, madje vinte buzën në gaz me dhembje.

Të them të drejtën, unë në fillim pata menduar ta pyesja për ndonjë paqartësi, duke menduar se frëngjishten do ta dinte më mirë se rusishten. Por më mundonte një sedër e theksuar, e cila sa të jep krahë, edhe të pengon në mësimin e gjuhëve të huaja. Sedra të shton vullnetin për të mësuar, por frika se mos po gabon, ët bën të skuqesh para se të gabosh dhe s'të lë të shprehesh lirshëm. I mësova përmendsh ato 16 faqe tekst në frëngjisht e në shqip, pastaj nisa të bëj analizën e përkthimit. Në të vërtetë përkthimi ishte shumë i mirë, por mua s'ma bënte qejfin se e doja fjalë për fjalë si fillestarët. Po më dilnin halle të reja me fjalorin dhe pikëpyetjet me laps të kuq po shtoheshin. Fjalori arriti në disa qindra fjalë, por gati gjysma kishte kuptime të dyshimta, madje edhe të kundërta, kurse disa të tjera gjysma kuptimesh. Iu ktheva me ngulm gramatikës, duke menduar se ajo e kishte fajin. Kur m'u mbush mendja se i kisha bërë "ujë" ato faje, e bëra zemrën "gur" dhe iu luta ambasadorit që të më dëgjonte një herë. Ai më dëgjoi me habi dhe më pyeti nëse kisha mësuar më parë ndonjëherë. Kur i tregova mënyrën se si kisha mësuar, ai shtrembëroi buzët dhe më dëgjoi pa dëshirë.

Teksa lexoja, duket se bëra një gabim trashanik (vetëm një?!) dhe ai qeshi me një zë të keq që më theri në zemër. Ndërsa përktheja, më shikonte me sy të çakërryer. E pyeta për disa çështje të thjeshta gramatikore, por nga shpjegimet e tij m'u mblodh një lëmsh në kokë. Te numërorët prapë bëra një gabim të pafalshëm. Duke u nisur nga analogjia, i thashë dy fjalë që nuk ekzistonin fare. Kjo e bëri të shkulej në gaz ambasadorin. Aso kohe unë s'e dija se frëngjishtja kishte mb-

eturina nga sistemi i numërimit vigesimal (një njëzetëshe, si shqipja e dikurshme: dyzet, trezet etj.). Që nga ajo ditë nuk e pyeta më për asgjë. Në atë kohë më erdhën dy buletine të shkencave shoqërore e natyrore, ku isha abonuar. Gëzimi im ishte i pafund kur pashë se pas çdo artikulli kishte një rezymè në fund. Tani materiali im u shtua së tepërmi. Të isha jashtë, vështirë se do të kisha lexuar, p.sh. për skifterin kthetraverdhë, shpend shtegtar që ushqehet me insekte, por halli të bën të shkosh edhe në derë të hasmit. E keqja ishte se shkurtimet e përmbledhjes nuk përkonin me tekstin e shkrimit. Kështu që detyrohesha të bëja përkthimin "me tahmin". Fjalori trashej, por unë nuk kënaqesha me kuptimet e nxjerra dhe mundohesha të shkrija dhjamë nga pleshti. Më kujtohet një artikull mbi përkrenaren ilire. Eh, sa djersë kam derdhur mbi të! Po artikuj të tjerë të arkeologjisë, që më kishin ardhur te hunda! Sidomos dy fjalë aty, që s'dija kurrsesi t'i përktheja, ma prunë ngushtë. Por, me gjithë mungesat, tani isha më i sigurt në vetvete. Materiali tani ishte shtuar Vura re i ngazëllyer se ato ishin revista "Temps Nouveaux" dhe i tërhoqa nga vetja. Por përgjegjësi, që dikur kishte qenë tregtar, ma mbajti dorën. "Është e ndaluar,- më tha. – Pa leje nuk mundem". Mora vesh se ishin të një të dënuari të kulturuar të shëtitur, që rrinte në dhomën tjetër, i veçuar nga unë. E lusja çdo ditë të merrte leje sa më parë, se kisha nevojë për to. Sa më shumë padurim tregoja, aq më tepër e zvarriste punën vegtari. Kur i thosha që të kërkoj leje unë vetë, më përgjigjej që të mos e prishja punën që ai e kishte vënë në vijë.

Tani përgjegjësi më lypte pa teklif çdo gjë, sidomos caraga të thata, të cilat i pëlqente shumë. Në të vërtetë, caragat i hante shumë edhe "macja" e burgut, se para zbulimit të revistave, dy-tri herë më kishte qëlluar ta gjeja torbën kur i mbaja përtokë, thuajse bosh dhe përgjegjësi më porosiste që t'i ruaja mirë se macja ishte kobashe e madhe. E keqja ishte se ajo, me sa dukej, ua shpërndante caragat edhe maceve të tjera, meqë llogaria tregonte se pesha edemit dilte më e madhe se e barkut të saj. Një ditë, mbasi më fjalor të çalë që kisha hartuar vetë! Çdo fjalë për mua përbënte janë problemë matematike me shumë të panjohura që më kushtonte shumë mund për ta zgjidhur, por edhe kënaqësi të veçantë kur i bija në të. Fletoret mbusheshin gjithnjë dhe frëngjishtja tani më ngjante si një egërsirë që kisha zbutur me durim dhe forcë vullneti, pa asnjë mjet tjetër, po mos llogarisja 30-40 kokrra vezë e ndonjë copë proshutë që kisha shpenzuar për të "zbutur" përgjegjësin – ruajtësin e thesarit – që mezi e bëri zemrën "gur" dhe më dha brenda disa muajve 3 revista.

Koha kalonte dhe ambasadorit i lejuan dy metoda frëngjisht dhe dy rusisht. Ai më kishte parë shumë ditë e net duke thyer kokën mbi rebuset e frëngjishtes dhe e qeshura përçmuese kishte ardhur duke iu ngrirë në buzë. Por edhe unë ama s'e hapja një herë gojën për t'i kërkuar ndihmë në hapat e parë, por edhe nuk ndjehesha shumë krenar kur m'u duk se kisha arritur diçka. Sepse gjuhët nuk janë luks, por shërbëtorë të njeriut. Më dëgjoi zemra t'i shikoja ato metoda në mënyrë që të kontrolloja dijen time e të zhdukja te torët" dhe gërhiste ndërmjet librit të rrëzuar dhe lapsit të varur.

Kjo skenë përsëritej çdo ditë, deri sa e la metodën e frëngjishtes, duke e cilësuar si gjuhën gjysmë të vdekur dhe kapi metodën e rusishtes, që qenkësh gjuha e së ardhmes. Unë, në muajin e tretë po mbaroja metodën e dytë të anglishtes, kurse ai s'po qulloste gjë as në "gjuhën e së ardhmes" dhe e la te mësimi i pesëmbëdhjetë, deri sa të kalonte të nxehtit. Isha i bindur se shumë stinë të nxehta dhe të ftohta do të kalonin për të deri në fund të këtij burgu dhe ai vështirë të mësonte gjë. Ndërsa unë po sulmoja gjermanishten në atë pisk vape, shpesh më shkonin sytë te blloqet e shkruara me qa kujdes të ambasadorit, por që kishin mbetur të panisur. E dëgjoja tek jepte mendime e konkluzione. Gjuha, po s'e fole nuk është gjuhë! Ama, për gjuhë burgu mësoj katër në vit! Janë disa që thonë se e dimë, por kur takohen me ndonjë të huaj, bëjnë mëk-mëk!

Një ngjarje na ndau me ambasadorin. Dhoma jonë u shkri, ai shkoi në kamp, ndërsa mua më transferuan te qelia e pronarit të revistave. E A mund të më dëgjoni paksa? Veç mos u trembni nga shqiptimi im. Unë nuk kam dëgjuar njeri të flasë frëngjisht.

Fillova të lexoja dhe prisja kur do shpërthente e qeshura e tij. Se ky kishte parë botë më tepër se ambasadori dhe diç kishte qenë më tepër se ai, e kishte hak të qeshte. Kisha vendosur të bëhesha më i durueshëm, dëshiroja ta shkelja sedrën time me këmbë. Ndryshe si do të mësoja? Po leximi vazhdonte e ai po buzëqeshte me dashamirësi. Oh, sa mirë! Oh, sa mirë! – Foli ai sinqerisht dhe pastaj vazhdoi të më fliste frëngjisht. Nga emocioni nuk mora vesh asnjë fjalë. U përflaka, por ai e kuptoi menjëherë dhe më tha: Mos u tremb! Kështu e kam pasur të vështirë edhe unë në fillim. Edhe unë me të vjedhur e kam shkollën. Më bëri vetëm nj vërejtje: Mbaresa "ent" e vetës së tretë shumës të foljeve në të pakryerën, nuk lexohet fare. Po edhe këtë ma tha në mënyrë kaq të njerëzishme, sa më erdhi turp për atë a hundore që unë e lexoja me një zë gomari për t'u dukur gjoja si francez. Më ndreqi edhe disa gabime të vogla. Në atë



mjaft dhe unë kisha "zgjidhur" tani shumë probleme, që bota i dinte me kohë. Mirëpo, unë isha brenda e "bota" jashtë. Megjithatë, fati s'do të ishte gjithnjë kundër meje.

Në ditë përgjegjësi i të burgosurve, i cili ndihmonte në hapjen e dyerve dhe ruajtjen e depos, po ziente qiriç me letra. Në mes të flakës, syri më kapi menjëherë disa fletë frëngjisht. Dogja duart duke u shuar nën britmat kërcënuese të përgjegjësit, që ankohej që ia lashë qiriçin pa rënë në valë. I mbajta dorën që të mos i hidhte letra të tjera zjarrit nga një turrë aty pranë. Ky s'ishte fort i dhënë pas leximit. I shpjegova se ndërsa unë po vuaja për një fletë në gjuhën frënge, ai po ia falte flakëve pa pikë mëshire. kishte premtuar kush e di për të satën herë se do të ma jepte revistën e parë, përgjegjësi i tha ndihmësit të tij: "Kam bërë një spinaq për të lënë thonjtë në të. Tani për vezë nuk di si t'ia bëj! Ka njëri, por s'kam qejf t'ia marr". Kam unë, – ndërhyra, – dhe i dhashë katër vezë. Vezë të mëdha, të freskëta, që m'i sillte nëna e dashur çdo muaj. E dija se një ditë para se të nisej në takim, ajo dilte ndër të gjitha shoqet e mëhallës për t'i ndërruar me vezë të freskëta, të porsadala nga furriku. Revista që mora kishte 48 faqe të ngjeshura me artikuj, përshtypje udhëtimi, kronika etj. Kur qeshë "i lirë", e kisha lexuar atë revistë në rusisht e, falë kujtesës, shumë gjëra i rikujtoja. Po ec e zgjidh frazat në frëngjisht me atë qeshurën tallëse të ambasadorit dhe nuk ia shtriva asnjëherë dorën, sado që i linte në një vend të dukshëm. Ai përgatiti fletoret, mprehu lapsat me kujdes te perberi, shkroi bukur blloqet me të kuqe e blu, caktoi orarin e punës krejt të detajuar, të gjitha shenja të sigurta se s'do të bënte asgjë. Në atë kohë mora edhe unë leje nga komanda e burgut të blija metodat e anglishtes dhe gjermanishtes dhe ndjehesha tepër i gëzuar. Ndërsa unë filloja studimin në pesë të mëngjesit dhe ndahesha nga librat kur bëhej pushimi, ai nuk e gjente lehtë pozicionin e përshtatshëm, nga ndenjur mbështetej në jastëk, pastaj pa e kuptuar, duke u shtrirë pak e nga pak në dyshek, niste e kotej dhe brenda dhjetë minutash ndizte "monjihnim njëri-tjetrin me të dëgjuar. Më priti mirë. Me turp i thashë se kisha mësuar gjuhë të huaja, po ashtu si mund të mësosh në burg. E falënderova për revistat dhe i thashë se ia kisha ruajtur që të mos i prishej koleksioni. "E ç'koleksion,- tha ai, – revista po u lexua, iku. Koha i kapërcen ngjarjet që përshkruajnë ato. S'kuptoj përse nuk i ke marrë të gjitha. T'i kisha lënë turrë në depo". I tregova historinë e vezëve. Hë, batakçiu, – tha ai, – sa këso lodrash më ka bërë edhe mua! Më foli aq fjalë të mira për studimin, thjeshtë e pa mendjemadhësi, sa m'u rrit guximi, nxora fletoret e mia të çuditshme dhe i tregova kaluarin tim të frëngjishtes. Pa metoda e fjalor, u habit ai. Të lumtë! Unë mora zemër. dhomë të errët të burgut lexova nja 6000 faqe reviste dhe rrallë kisha nevojë të pyesja…

Këtë histori ta shkrova për të treguar se kushtet e mira nuk janë gjithçka për të mësuar. Kryesorja mbetet sedra, ambicia pozitive. Madje, shpesh njeriu me sedër, mungesa e kushteve nuk e pengon, por e shtyn të përpiqet të kalisë një vullnet të hekurt për të mësuar. Tani mund të them i sigurt se frëngjishten ma ka mësuar "e qeshura" e atij ambasadori, sado që ai vetë mbeti tek mësimi i pesëmbëdhjetë.

*Të përqafoj,*
*daja yt që të do fort,*
*PJETRI - 27 maj 1986*

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Prokurori amerikan ndjek gjyqin e zyrtarit për korrupsion



Prokurori amerikan Gjon Juncaj i atashuar në hetimet e dosjeve të korrupsionit pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda zbret në terren dhe për herë të parë ndjek nga afër procesin gjyqësor ndaj një zyrtari të akuzuar për korrupsion.

Juncaj ishte i pranishëm në procesin ku i pandehur për ryshfet në vlerën e 80 mijë eurove është gjyqtari i Sarandës Rasim Doda.

Përgjatë seancës e cila zgjati për afro 15 minuta me anë të ndihmesës së tij, Juncaj u interesua hap pas hapi për mënyrën e zhvillimit të gjykimit dhe përfaqësimit të akuzës nga dy kolegët e tij shqiptar Manjola Kajan dhe Genti Osmani.

Teksa mori fjalën për të kërkuar shtyrjen e seancës pasi avokati i tij ishte i sëmurë, gjyqtari i pandehur akuzoi prokurorinë për një proces të stisur.

Prokuroria kishte planifikuar që në këtë seancë të dëgjohej dhe dëshmia e Hasan Bushit personit që shihni në këto pamje, i cili 5 muaj më parë kallëzoi penalisht gjyqtarin Doda se i kërkoi para në këmbim të një vendimi.

Në kushtet e mungesës së avokatit të dytë të Dodës, gjykatësi Bib Ndreca vendosi shtyrjen e seancës për më 30 tetor.

Prania për herë të parë e një prokurori amerikan në sallë, solli dhe ndryshim rrënjësorë të Gjykatës së Krimeve të Rënda sa i përket transparencës ku media u lejua të ndjek gjyqin nga fillimi në fund dhe nuk u nxor jashtë siç ndodh rëndom kur në sallë nuk ka përfaqësi të huaj.

# Zgjidhje kombëtare emergjente për Parkun Kombëtar të Valbonës

Nga **Alfred Lela**



Nga Tirana mund të mbërrish në Valbonë për rreth katër orë me makinë. Duke udhëtuar sigurisht nëpër Rrugën e Kombit për të kapur Kukësin e më pas nëpërmjet Prizrenit e Gjakovës për t'u hedhur në Bajram Curr, nga ku mund të ngjitesh përpjetë Luginës së Valbonës në 21 kilometra rrugë. Nëpërmjet peizazhit që shtrihet në dy anët e saj, natyra e kapërcen atë që ne dimë për të poshtë nëpër qytete: koncepti që ne kemi për të në formën e ca pemëve, një parku apo një ligatine që quajmë lumë.

Valbona brenda kësaj bukurie e kthjelltësie ka megjithatë telashet e saj. Ka problemet e atyre që ikin diku tjetër e atyre që kthehen aty prej nga ku kanë ikur dikur; atyre që duan ta vizitojnë e atyre që u duhet t'i presin këta vizitorë; atyre që u duhet të ngrenë një biznes, apo atyre që u duhet ta qeverisin këtë istëm të dorës së Zotit. Të gjithë atyre bashkë, megjithatë u duhet, nën një fije të hollë balance, edhe ta ruajnë por edhe ta zhvillojnë Valbonën. Ta ruash do të thotë të jesh konservator me burimet e saj natyrore dhe me mjedisin, por gjithashtu ta bësh të aksesueshme që kjo bukuri t'u shpaloset edhe të tjerëve, vendas apo të huaj qofshin. Kjo do të thotë infrastrukturë: rrugë, hoteleri, energji elektrike apo mundësisht edhe elementë që duken si luks: pista skish, teleferikë, telefoni etj.

Rexh Byberi, kryetari i komunës së Margegajt, ku përfshihet Lugina e Valbonës me nëntë fshatrat e saj, sheh si emergjente për zhvillimin e zonës përfundimin e rrugës që lidh qytetin me Valbonën si dhe hartimin e një plani rregullues. Është shtruar rreth gjysma e segmentit Bajram Curr-Valbonë me asfalt, ndërkohë që pjesa tjetër gjarpëron teposhtë nën kapriçot e motit: kur ditët janë të mira ajo është lehtësisht e kalueshme edhe nga makinat e vogla, por kur bie shi apo borë, që është gjendje kryesore atmosferike e zonës, rrëmoret marrin teposhte gurë e dhe, gërryejnë rrugën ose i hedhin përsipër një shtresë akulli që e bën të pakalueshme. Mosndërhyrja për të asfaltuar pjesën e mbetur duket se po ndikon në shkatërrimin edhe të pjesës së përfunduar së shtruari dhe sistemuari që vjet.

Një plan rregullues do t'i lejonte pushtetit vendor dhe biznesit apo dhe donatorëve, të fitonin qartësi mbi kufizimet dhe mundësitë e veprimit në zonë. Edhe pse Valbona është Park Kombëtar, çka parashikon konservatorizëm në lidhje me ndërtimet e hoteleve apo restoranteve, këto të fundit janë jetike, jo vetëm si resurse ekonomike për banorët e zonës, por edhe për t'i mbajtur në hartën turistike Alpet shqiptare. Në 21 km gjatësi janë ndërtuar rreth 8-9 hotele, të cilat e kanë konservuar traditën ndërtimore dhe etnografike të zonës duke mos dalë jashtë karakterit alpin të saj. Lejet e ndërtimit, për vetë karakterin specifik të një Parku Kombëtar, janë një gjë e vështirë dhe që merr kohë të gjatë dhe disa prej banorëve të zonës të kthyer nga emigrimi, i kanë investuar fitimet e tyre në hotele apo restorante për të cilat shpresojnë t'i legalizojnë, edhe për atë që, siç thonë, kanë ndërtuar në tokë të vet dhe në harmoni me peizazhin dhe traditën.

Lugina e Valbonës është një rast sui generis. Ethja e prishjes së ndërtimeve, me apo pa leje që ka kapur qeverinë e re, nuk ka pse të ngjitet kaq lart. Jo vetëm se atje nuk ka shumë për të prishur, por edhe se prishjet këtu do të ishin një lloj terrori psikologjik, ndaj popullsisë së pakët lokale por sidomos ndaj sipërmarrjes së emigrantëve të kthyer, që me pak lekë e për pak punë duan të ndërtojnë diçka në vendlindje.

Ministria e Turizmit apo institucione të tjera përgjegjëse janë nën peshën e nevojës akute për hartimin e një plani konkret e të detajuar për Luginën e Valbonës, për këtë pasuri kombëtare së cilës i duhet gjetur një zgjidhje kombëtare. Është një qosh i lumtur dhe i mrekullueshëm i trupit të Shqipërisë dhe duhet bërë diçka e gjithçka për ta shpëtuar: jo vetëm duke e ruajtur, kjo nuk mjafton, por duke e futur brenda një strategjie zhvillimi e funksionalizimi



# Lubonja: Ky vend ka marrë fund, ka ngelur vetëm arratisja Të varfrin s'kanë para për të dhënë ryshfet si majtas si djathtas



Gjatë këtij viti nga Shqipëria janë larguar vetëm drejt Gjermanisë 67 mijë shqiptarë çdo muaj, pra në 10 muaj 6070 mijë vetë.

Sipas statistikave zyrtare gjermane, emigrantët shqiptarë në Gjermani janë të dytët nga numri pas Sirisë, prej nga njerëzit ikin prej luftës. Por kjo është një dukuri shqetëuese në dy dekada.

Analisti i njohur Fatos Lubonja thotë se është dramatik krahasimi me Sirinë 19 milionë banorë, që ikin sepse bombardohen çdo ditë, kur Shqipëria nuk ka luftë, por njerëzit ikin njëlloj.

Zoti Lubonja thotë se sot pas 25 vitesh Shqipëria është përsëri në një gjendje të ngjashme me luftën dhe kjo tregon dështimin e plotë të klasës politike, ekonomike dhe mediatike të vendit, si dhe dështim i sistemit gjyqësor.

Sipas tij, shqiptarët po ikin nga atdheu, sepse kanë ankth prej pasigurisë për të ardhmen, sepse qeveria nuk i jep asnjë siguri për të ardhmen e afërt, ndërkohë që ekonomia nuk është e qëndrueshme.

Shumica janë të papunë, thotë ai, por pak njerëz e dinë në Shqipëri se cila do të jetë puna e tyre të nesërmen, të gjithë punojnë dhe grabitin sot për sot.

Të varfërit nuk kanë para as për të ngrënë as për të shpërndarë rryshfetet e majme që u kërkohen majtas djathtas, theksoi ai.

Zoti Lubonja thotë se Shqipërinë po e braktisin edhe të shkolluarit edhe të pashkolluarit, po ikin me shpejtësi nga atdheu edhe krahu fizik i punës, edhe të diturit.

Por më e keqja, thotë ai, është edhe ata që po rrinë këtu kanë braktisur pjesëmarrjen në veprimtari demokratike sepse ndjehen të pafuqishëm dhe të nënshtruar përballë arrogancës dhe indiferenca e pushtetit dhe e politikës.

Njerëzit janë mbyllur në vetvete, në punët e tyre dhe nuk marrin pjesë në ndryshimet që ka nevojë shoqëria, thotë ai.

Zoti Lubonja mendon se të katër pushtetet; politika, ekonomia, media dhe gjykata janë përgjegjës për këtë hemoragji të rëndë, ku ata vazhdojnë të korruptojnë njëri tjetrin deri në skaj, thotë ai për VOA.

Rrugëdalja e parë, sipas tij, është përpjekja e pamjaftueshne për t'i demokratizuar dhe emancipuar me lëvizje kulturore. Rruga tjetër është lëvizja popullore.

Por aktualisht nuk ka as demokraci në udhëheqjen politike dhe as lëvizje popullore dhe kjo gjendje është më keq se status quoja.

"Autoritetet politike dhe pushtetare po qeverisin territore të zbrazura nga popullata dhe territore të zbrazura nga ambicjet e njerëzve për liri, dinjitet dhe demokraci" – tha zoti Lubonja.

Nga kjo situatë, thotë ai, mund të dilet vetëm me kurajo qytetare dhe me angazhim të gjerë demokratik të shoqërisë.

# Mafian kosovare ne trafikun e emigranteve ne Ballkan

Me titullin "Rruga e Ballkanit", mes kotrabandistëve që lëvizin murin e fundit", e përditshmja italiane "Avvenire", sell një reportazh i cili denoncon rolin e mafias kosovare në trafikun e emigrantëve klandestinë përmes tokës.

"Nëse një emigrant fsheh në çorape një numër telefoni që nis me 00383, nënkupton vetëm një gjë; Mafia Kosovare është në veprim," e nis shkrimin gazetari Nello Scavo. "Askush më mirë se xhelatët e tij i njeh rrugët e malit e "shkurtoret" doganore…asnjë telefonatë vetëm, sms për të komunikuar…"

Gazetari italian ka udhëtuar deri në Prishtinë për t'u njohur personalisht me trafikuesit kosovarë të qenieve humane, emigrantë që përmes Ballkanit udhëtojnë drejt Evropës. "Të pashqetësuar prej vitesh trafikantët kosovarë tregtojnë drogë, armë, cigare, karburant, bizhuteri të çmuara, mijëra makina e bizhuteri të vjedhura. E kurrë nuk përfundojnë të ulur para një gjykatësi", vijon gazetari.

Trafikanti që vepron për mafian kosovare e quajnë Ivan, Goran, Anatolij ose mund të ketë shumë emra të tjerë, por mund te jetë dhe rus o çeçen.

"Takimi me njeriun me shumë emra është në Prishtië, nën një diell që të pëllcet kokën, rrëfen gazetari, në mes të bulevardit pretendues "Nënë Tereza", dedikuar të Lumes Nënë Tereza të Kalkutës e kolonizuar nga resotrantë e botikë të firmave të mëdha. Rruga e këmbësorëve përshkohet nga riprodhimi në bronz i dëshmorëve të UÇK, rënë gjatë Luftës të ish Jugosllavisë e që kujtojnë se "jemi një popull i vogël i një vendi të madh", një frazë e "Gandit të Ballkanit", të paharruarit presidentit poet Ibrahim Rrugova."



"Deri një javë më parë, tregon trafikanti, një udhëtim me makinë nga Presheva në kufirin hungarez kushtonte 300 euro. Sot ky cmim është dyfishuar. Shuma para paguhet e nëse emigranti vdes gjatë rrugës, kasa e kontrabandës nuk "qan". Kjo rritje çmimesh është shkak se për të evituar policinë e rrjetën metalike të ngritur në Budapest, trafikantët e Kosovës kanë gjetur rrugë të reja kalimi në kufirin hungarez-serb."

Sipas rrëfimit të kontrabandistit tashmë rruga e Ballkanit për emigrantët që duan të kalojnë përmes tokës drejt Evropës, ndjek dy linja;

Linja e parë jo shumë e përdorur, parashikon kalimi përmes Serbisë, hyrjen në Rumani, më pas në Hungari përmes kufirit lindor. Kjo rrugë është pak e praktikueshme për shkak të terrenit shumë malor.

Linja e dytë shkon drejt Kroacisë, përmes Serbisë, duke hyrë në Hungari e duke vazhduar në drejtimin Austri e Sllovaki. Kjo është mënyra e vetme për të vepruar përreth rrethit 175 km kërkuar nga kryeministri hungarez.

"Lugina e Preshevës, shkruan gazetari është një tokë e humbur ku është më lehtë të gjesh një kontrabandist se sa një hidraulik. Pikërisht këtu dredhojnë shtigjet më të paarritshme."

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Vjedhja 600 milion euro ne CEZ, Edi Paloka: Rama mbylli çdo rrugë për drejtësi, e shpalli armik te popullit dhe KLSH-në

Kreu i Grupit të PD-së, Edi Paloka denoncon me ashpërsi, goditjen që Kryeministri Rama po i jep Kontrollit të Lartë të Shtetit, pas kallëzimit që ky i fundit i bëri dy zyrtarëve të lartë të qeverisë për një dëm prej 479 mln eurosh në marrëveshjen me CEZ-in.

Paloka shpjegoi se pikërisht këto sulme ndaj institucioneve të pakta të pavarura që kanë mbetur në vend, e kanë shtyrë PD-në të kërkojë hetim të pavarur për aferën CEZ: "Po nëse do të guxonte një prokuror të bente detyrën, ta çonte përpara procesin? – ngriti pyetjen ai. – Eshtë e qartë se çfarë do të ndodhte. Edi Rama do ta shpallte armik të popullit, siç po bën me KLSH-në. Ai po i jep mesazh çdokujt që guxon të bëjë detyrën sipas ligjit, që të heqë dorë."

"Tani që bomba e CEZ-it ka shpërthyer, Edi Rama është hedhur në sulm për të mbyllur çdo rrugë që të çon tek drejtësia, – tha Paloka në fjalën e tij. – Kur ne kërkojmë hetim ndërkombëtar sepse në aferën e vjedhjes së 600 milionë eurove janë përfshirë kryeministri, kryetari i parlamentit, pra njerëzit më të pushtetshëm në vend para të cilëve prokuroria jonë zor se do të qendronte në këmbë, Edi Rama thotë se jemi vend sovran.

Kemi institucionet tona thotë Edi Rama, dhe mbyll kështu një rrugë që të çon tek drejtësia. Kur vjen puna tek institucionet tona, meqë jemi vend sovran, nëse këto institucione guxojnë të bëjnë punën e tyre ato bëhen objekt sulmi skandaloz. Kontrolli i Lartë i Shtetit verifikoi dëmin që Edi Rama ka shkaktuar me marrëveshjen që bëri me firmën çeke, dhe shihni çfarë ndodh. Prej asaj dite KLSH është nën goditje të vazhdueshme prej kryeministrit.

Pse? Sepse edhe kjo rrugë që të çon tek drejtësia, dhe duhet mbyllur. A do të sulmohej KLSH nëse do të mendonte si Edi Rama. Nëse do të mbyllte pazarin e tij, a do të goditej ky institucion. Jo aspak. Ashtu ne do të ishim vend sovran. Por kur KLSH bën detyrën e mbron interesat e vendit, atëherë shpallet armik i popullit.

Letrat janë aty. Provat e faktet janë aty. 600 milionë euro, detyrime të pranuara nga vetë kompania CEZ, që iu falën, dhe më keq, u ndanë me kompaninë çeke nga Edi Rama.

Po nëse do të guxonte një prokuror të bente detyrën, ta çonte përpara procesin. Eshtë e qartë se çfarë do të ndodhte. Edi Rama do ta shpallte armik të popullit, siç po bën me KLSH-në. Ai po i jep mesazh çdokujt që guxon të bëjë detyrën sipas ligjit, që të heqë dorë.

Nuk do drejtësi Edi Rama për aferën më korruptive të historisë së vendit. Me çdo kusht nuk do drejtësi. Të gjithë e kuptojmë qartë pse ndodh kjo, pse Edi Rama gjendet në këtë ditë ku e kanë zënë ethet nga drejtësia. Sepse është fajtor, është i përfshirë vetë, këmbë e krye. Po të ishte për damianët e tij, tani që kjo çështje po rëndon shumë, ai do ti kishte hedhur këta zëdhënës të paktit kriminal, si bagazhet e tepërta, e vetë do të shpëtonte.

Madje, me gjasë do bënte dhe burrin e mirë, e do thoshte të bëhet drejtësi. Por se bën dot, sepse kjo vjedhje e shqiptarëve ka emrin e tij. Kjo megaaferë ka firmën e tij, vulën e tij. Çdo hetim do ta merrte me vete. Eshtë zullum i madh, është mëkati më i madh financiar që i është bërë vendit. Damianët do flisin, dhe në rrokullisjen e tyre marrin me vete dhe padronin. Drejtësia për këtë çështje është fundi i Edi Ramës. Dhe ai po bën gjithçka për të mbyllur drejtësinë.

Nuk pranon kërkesën e opozitës për hetim ndërkombëtar, ju e dini se nuk e futi sërish në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Për këtë, iu ul edhe një herë në gjunjë Ilir Metës.

Nga dëshpërimi thirri në ndihmë një kopje të damianit, një kopac që çuditi europën kur tha se CEZ ishte kuçedra që i kishte zënë grykën të ardhmes së vendit, që kishte në dorë statusin e vendit kandidat. U përgenjështrua 3 herë kopaci i Ramës. Nga Republika Ceke dhe nga Bashkimi Europian. Pra nuk ishte çështje statusi e integrimi, ishte pazar. Tani sulmon KLSH-në. I bën presion prokurorisë. Dhe rrëzon kërkesat e opozitës për hetim ndërkombëtar. Pra po e shpall veten të pahetueshëm.

Edi Rama po na thotë se paska një imunitet ekstra, se nuk bën të ketë dyshime mbi të, dhe nuk bën të ketë drejtësi mbi të. Paska zbuluar kështu se qenka i dërguari i të plotfuqishmit, dhe e di ai se çfarë bën me paratë e shqiptarëve, kujt ia jep, si i ndan. Është puna e tij.

Siç po bën në çdo drejtim, çdo ditë. Ky spaçator tenderash, që i vë gishtin fituesit para se të nisin procedurat.

I jep ndërtuesit të sarajeve të tij çdo tender, carapulët e tij marrin të gjitha paratë dhe mundësisht shfaqen me ofertën më të lartë që të mos kursehet asnjë qindarkë.

Këtë po bën në shendetësi e kudo. Vjedhja e zhvajtja është kthyer në epidemi. Ministra që fitojnë me kompanitë e tyre 28 tendera në 22 muaj. Lamja që merr qindra milionë lekë për një produkt që tashmë ekziston. Ministri tjetër që ruan linjat e drogës. Kontrabanda gëlon.

Dhe në krye, Edi Rama, që nuk do drejtësi. I druhet drejtësisë si temjanit.

Partia Demokratike nuk do ta lejojë. Ka një forcë madhore të cilën nuk e urdhëron dot Edi Rama. Është bashkimi i qytetarëve dhe kërkesa për drejtësi. Ky është sovrani që nuk mbyllet dot zyrave me urdhër. Aty do të shkojë çështja, tek sovrani. Paratë do të gjenden, do t'u kthehen qytetarëve, dhe ligji do veprojë me gjithë pushtetin e tij mbi përgjegjësit



# Si ta zgjojme detin nga gjumi

**Nga Preç Zogaj**

Shqipëria në detin Adriatik dhe Jon është pak më e vogël se Shqipëria në tokë. Kemi 427 kilometra bregdet. Kemi ultësirën më të madhe bregdetare të mbarë Adriatikut lindor; baseni nga gjiri i Vlorës në derdhjen e Bunës përfaqëson një port natyror gjigant dhe unik; ky det dhe pozicioni gjeografik i kanë dhënë Shqipërisë atributet e Gjibraltarit të Adriatikut. Në këtë konfigurim gjejmë një prej arsyeve themelore pse na kanë copëtuar kur mund të na copëtonin – histori tragjike, fatmirësisht e mbyllur tashmë, që na fton të kthejmë sytë me një përkushtim të shumëfishtë nga ky tandem i fjetur – pozicioni gjeografik dhe deti – që ngërthen diçka nga e vërteta thelbësore e sekretit tonë dhe fatit tonë si komb. Por, paradoksalisht dy detet shfrytëzohen pak, lundrohen pak, peshkohen pak, shijohen pak, si të mos e dimë se çfarë minierash dhe bekimi janë për ne. Për rrjedhim, pozicioni gjeografik i vendit si një thesar me vete, vazhdon të jetë i fjetur.

Sot nuk tranzitojmë pothuajse asnjë ton mall, kur edhe Sllovenia, me 47 km bregdet kodrinor, që ka konkurrente Triesten, përpunon dhe tranziton rreth 17 milionë tonë mall nga porti i saj i Koperit. Nuk kemi asnjë port turistik (rreth një mijë e dyqind ka Kroacia); nuk kemi flotë peshkimi aktive, me një lule, siç është "Rozafa" apo ndonjë kompani tjetër, nuk vjen pranvera; portet e vjetra të peshkimit janë shndërruar rëndom në varreza anijesh të braktisura. Konsumojmë si popull më pak peshk se sa vendet që nuk kanë fare dalje në det, vetëm dy-tri kg për frymë në vit. Kemi një rrjet fabrikash moderne të përpunimit të peshkut blu, të sardeles dhe açugës për eksport, në Durrës, Lezhë, Shkodër, Elbasan. Por ato e marrin gjithë peshkun, deri në kilogramin e fundit, në Kroaci dhe në vendet e tjera të botës.

Vetëm "Eurofish" në Lezhë, fabrikë e madhe moderne që punëson 550 punonjës, ka kontrata me rreth 80 anije peshkimi kroate apo të ndonjë vendi tjetër, që punojnë kryesisht për të. Imagjinoni: tetëdhjetë kapitenë, tetëdhjetë motoristë, tetëdhjetë stafe peshkatarësh, pa llogaritur punonjësit e prapavijës, serviseve, fabrikave të akullit, prodhuesve të arkave – pra një zinxhir i tërë veprimtarish dhe njerëzish që punojnë kryesisht për një fabrikë shqiptare. Sikur të kishim në Shëngjin apo në Durrës vetëm gjysmën e këtyre anijeve, do të kishim bazat e një industrie të mirëfilltë të peshkimit. "Eurofish", "Rozafa" dhe "Poseidon" janë ngritur në Lezhë vite më parë, pikërisht në funksion të afërsisë me detin, duke shkuar me mendimin se lënda e parë është në derë të shtëpisë. "Rozafa", që i është dedikuar zënies fundore për tregun e freskët dhe restorantet, ka arritur të ketë me shumë sakrifica dy anije bashkëkohore të vetat.

Të tria kompanitë përpiqen prej vitesh të sensibilizojnë qeveritë, duke ofruar propozime shumë interesante për ngritjen e industrisë së peshkimit në Shqipëri, propozime që rëndom kanë përfunduar në sirtarët e nënvlerësimit të detit si resurs. Këtu nuk është fjala për të qenë xheloz pse peshku si lëndë e parë vjen nga jashtë. Jemi vend i hapur, fabrikat do të punojnë. Por në dallim nga fasonët e këpucëve apo konfeksioneve për të cilat në Shqipëri mungon lënda e parë, për fabrikat dhe frigoriferët e peshkut nuk mungon lënda e parë. Kemi "arën" tonë të pakrahasueshme, kemi një traditë tonën të peshkimit që është rrënuar, por mund të ringrihet.

Një fjali e shpjegon këtë gjendje: mungesa e një politike eficiente dhe vizionare për detin.

Nxjerrja e detit nga gjumi, ndryshimi, shndërrimi i detit në një burim të madh punësimi, zhvillimi dhe mirëqenia për Shqipërinë dhe shqiptarët duhet të nisë pikërisht nga vendosja e detit në top-listën e prioriteteve të qeverisë, nga marrja në zotërim e hapësirës detare për t'ia kthyer publikut, nga ndërtimi i politikave të reja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, me studime dhe projekte konkrete, me masa dhe incentivë të lidhura organikisht brenda një vizioni tërësor për portet, peshkimin, turizmin, si dhe për themelimin e tranzitit euroballkanik nëpërmjet territorit tonë.

Themelimi i tranzitit kërkon patjetër rrugë, siç është Rruga e Kombit, apo siç do të ishte Korridori Tetë. Por tranziti nuk mund të kuptohet pa porte të mëdha, aty ku mëma natyrë i ka shënjuar me dorë bujarisht, në Vlorë (jo në Pyllin e Sodës), në Shëngjin, në Seman dhe në Kallm të Durrësit. Një studim i Forumit për Zhvillimin, një bashkim profesionistësh e intelektualësh që punojnë prej vitesh për një strategji të zhvillimit të infrastrukturës tokësore, bregdetare dhe detare, parashikon ndërtimin me koncesion të Europortit të Shëngjinit, me kapacitetet përpunuese për anije deri 500 mijë tonëshe.




Ky port i madh nuk është më vetëm një ide, një ëndërr, por është një studim i plotë dhe një projekt i vlerësuar në forumet e specializuara ndërkombëtare dhe i mirëpritur nga shumë liderë politikë në Bruksel, në Tiranë dhe në Kosovë. Ky port do të shërbejë për tranzitin e mallrave të Ballkanit Juglindor me vendet e Mesdheut dhe Atlantikut. Dhe anasjelltas. Me ndërtimin e Europortit të Shëngjinit, edhe Rruga e Kombit do të shtojë qarkullimin, sepse mallrat e Serbisë, Maqedonisë e tjerë do të tranzitojnë nëpërmjet Kosovës. Janë të gjitha mundësitë që ky port të ndërtohet me koncesion. Ka shumë sipërmarrje të mëdha, sidomos gjermane, që kanë shprehur interes të veçantë për të. Kërkohet sovranitet dhe përgjegjësi vendimmarrëse për të përgatitur gjithë dokumentacionin ligjor dhe për të shpallur tenderin ndërkombëtar. Europorti i Shëngjinit do të jetë vepra që do ta përfshijë Shqipërinë me titull të plotë në hartën e interesave ekonomike rajonale dhe me gjerë.

Bregdeti shqiptar ofron kushte të favorshme për ndërtimet me koncesion të porteve turistike dhe të peshkimit sepse zotëron gjire, delta lumore, laguna, ultësira bregdetare dhe praninë e lëndës ndërtimore.

Politika për detin do të kërkonte rrokjen e gjithë elementeve që nevojiten për t'i dhënë jetë industrisë së detit si produkt i bashkëveprimit qeveri-privat-bankë. Lirimi i menjëhershëm i porteve ekzistuese të shndërruara në varreza anijesh, administrimi efikas i hapësirës detare, ndërtimi me koncesion i porteve të reja të peshkimit në bazë të studimeve të bëra, krijimi doradorës i flotës së peshkimit nëpërmjet politikave nxitëse të kreditimit, mbështetja e nismave ekzistuese dhe zgjerimi cilësor i arsimit profesional për industrinë e peshkimit me gjithë aksesorët e saj – të gjitha këto janë çështjet kyçe të paketës së re të qeverisë së re të Rilindjes për të ngritur në këmbë industrinë e detit.

Sipas Forumit për Zhvillimin, mbështetur në resurset e studiuara të vendit dhe në përvojën e vendeve fqinje, siç është fjala vjen Kroacia, është e mundur që në harkun e katër viteve Shqipëria të ketë shtatë-tetë portet e para të turizmit, katërpesë porte të reja peshkimi, të ketë një flotë aktive me anije të reja të privatëve shqiptarë apo të marra me huazim nga vendet fqinje, të dyfishojë konsumin e peshkut për frymë, të plotësojë më shumë se gjashtëdhjetë për qind të nevojave për lëndë të parë të fabrikave të përpunimit të peshkut blu, të rivendosë në shtratin e traditës së mirë profesionin e peshkatarit, riparuesit dhe ndërtuesit të anijeve.

Më tej, vendosja e industrisë së detit si përparësi e qeverisë do të kërkonte në rrafshin e vendimmarrjes afatshkurtër edhe një serë masash të tjera për të krijuar standarde dhe lehtësira për operatorët e sektorit, për të luftuar konkurrencën e pandershme dhe kontrabandën. Biznesi privat që ka mbijetuar dhe përpiqet të mbajë gjallë ato elemente të pakta të industrisë së detit ka ide shumë të qarta për perspektivën e shkëlqyer të kësaj industrie, ngritja në këmbë e së cilës do të shënonte fillimin e një ere të re për ekonominë shqiptare.

# Former employee of Secret Service through the dark labyrinths of crime

Post-communist period, ie. from 1991 onwards it was dark enough for the Albanian people. Only three years, from 1997 to 2000 were executed without trial 4100 innocent Albanians after intentional opening of arms depot, which passed into the hands of the population. Country always, even today, unfortunately, resembles a well-organized mafia, where reckoning is stimulated by so-called organs of state security. The Interior Ministry has to date always been political in open conflict with the General Prosecutor. Here has recently emphasized the US 's Ambassador Donald Lu, who labeled this conflict and these clashes as products of corruption, where government executives, judges and prosecutors are very rich, although they have quite low payments in comparison with other countries in the region. Honest people, specialists and experts, are finding it impossible to make their contribution to the state organs or services. One of them, Aleksandër Vija, an employee of the intelligence service for many years, from 2001 till 2006, only because he worked with integrity and dedication, became a victim and his life slipped through the dark labyrinths of crime. They found an alibi to motivate the firing him in an absurd way "shortened the work place". Officially you cannot find any remark at work, but some former colleagues speak good words and different groups related to crimes and terror were angry with former employee of Secret Service (SHISH) Vija and had planned interventions to eliminate him physically after he was fired in 2006. To gain some political immunity, he joined the Socialist Movement for Integration (LSI), which was probably a smart move, because despite threats and criminal backstage, he managed to save the life and today he is not killed like hundreds of others. We learned more from the Prosecutor's office in Shkodra, that on June 23, 2013, ie. on the day of parliamentary elections, Aleksandër Vija was charged seriously with accusations that he as representatives of the LSI has distributed money in exchange for voting for political party LSI together with a citizen Samir Kajoshi and police had arrested and mistreated them. After a long investigation, the criminal case Nr. 760 against the two above mentioned persons, was dismissed by the Prosecutor's Office of Shkodra as not based in fact and law. But threats to his family and to the former employees of the Secret Service does not stop. He was forced to lay criminal charges on 07.05.2015 against citizens GJ.M. and N.A. who had threatened him in his home by physically violating his wife and the small daughters. This criminal report has the number 1141, but this case was surprisingly dismissed, however, the former employee of the Secret Service is going his odyssey really between threats, while the state is accused daily with facts from the media and the international community that cooperates with crime and corruption and this is the refrain of the day post-communist Albania.

**The Editorial Office**

Shqipëria Etnike

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Properties are an unsolved problem; They have produced social conflicts and thousands are killed in the past 25 years.

According to the statistics, in the past 25 years they have been over 2000 innocent people killed only as a result of confusion with the properties. Many notaries and judges have alienated the real owners of the property, which has produced tensions, injuries and murders. Around 400,000 buildings have been built in Albania without permission. According to an analysis that has been worked out by the World Bank, roughly a third of the land in which there are illegally built facilities is a property of the builders, one third of the state, and a third of it, belongs to another person, ie. a real mess. Legal documentation is non-existent and in almost all cases, conflicts are resolved by force. There have been murders for a canal, a wall, a fence, or a narrow street. The case in question, where the citizen Ermal Qemal Kurtoviq, resident in the village of "Shtoj i Vjeter", a unit of Shkoder country, currently threatened with life, is a conflict in the wake of a tragedy. This person has a conflict for many years precisely with the son of his uncle, called Saimir Mehmeti, for a fence that separates the land of the two persons. Saimir Mehmeti claims that the fence in question should be postponed further, as they have the land adjacent and he is making pressure with self-judgment to divert the fence to free up more space for him, while Ermal Kurtoviq says the fence is in the right place and he is ready to address to the municipal law and ultimately to the village elders, but without result. Occasional pressures have degenerated into physical violence and threats against the citizen Ermal Kurtoviq's life. About the time 19:00, September 17th 2015, the citizen Saimir Mehmeti went to the land of the citizen Ermal Kurtoviq and attempted to move the fence from the place. Ermal Kurtoviq has seen him and he immediately went to protect his property by insisting that the fence has been there for a long time and that is the border of the property, but the cousin threatened him, saying that he "would move the fence, no matter what his cousin says or want, or if it belongs or not to him, he will kill him, because he makes the law by himself." The conflict has degenerated until Saimir Mehmeti pulled a pole (wood) from the fence to attack and hit him on the head, saying that he would kill him, but fortunately some bystanders happened to be close to them, and one of them, from the village Guci e Re intervened between and stopped a tragedy, because there is a fence separating their properties.

This event is reported immediately to the Operating Room of the Police and the offended part Ermal Kurtoviq has filed criminal charges at the Judicial Police of the Department of Prevention of Crime at the Police Station in Shkoder. But precisely this criminal accusation has aggravated even worse the situation. Saimir Mehmeti was arrested from the police, but he had known people there too and after 24 hours he gets out. Very angry, he decided to retaliate and on September 20th 2015, Saimir Mehmeti went in the Ermal Kurtoviq's house and threatens him with life by using the pistol. Ermal's father, to save his son's life, took a knife and kills Saimir Mehmeti. So, the situation fester more. From that day, the family of Ermal Kurtoviq is on a serious danger. So, a conflict that continue from many years, now is much more tensed.

**The Editorial Office**

# Refuses the relation, a girl is threatened for life



There are numerous cases in Albania where young girls, especially students, have become victims of their beauty and endurance of men to create relation with them, even when they have refused. One such a case is that of Lizabeta Zef Pllumaj, born on May 28, 1996 in the village Tamara of Great Highland. It was a high school student in 'Don Bosco' in Shkodra and lived in a sisters dormitory and she had an exemplary behavior. Normally such a girl would attract the attention of men, but this is not the best of coping with a guy named Klaudio. On May 6, 2015, the boy who was accompanied by some friends stopped her in the street and commanded her saying: "You will come with us", but Lizabeta that was going to dormitory opposed him and warned him that she will inform the police. But the boy attempted to forcibly bring her to the car. The "Don Bosco" student screamed loudly and was seeking for help. At the moment Klaudio pulled out a knife and threatened her, that she must not make noise, otherwise he would kill her. Lizabeta saw that he was also armed with a pistol in the waist, but luckily enough there were around her friends from the school on the streets in direction of going from school to the dormitory and Klaudio became afraid and released the girl, but threatened her that "You do not dare create a relationship to anyone else but me, otherwise I kill you and him, too. And if you report me to the police, I'll find and kill you. You cannot hide from me, because I'll find you wherever you go. I am a socialist and we have our own state now." This threat was made in a sunny day, in the middle of the city of Shkodra, terrorizing other students, too, which were eyewitnesses to this event. Unable to inform the police and the lack of the confidence, since in most cases the police do not keep the secrecy and cooperate with criminal persons, this girl with some other students have complained in complete confidence to the Office of the Democratic Party in Malesi e Madhe (Great Highland). The aid that the office of Democratic Party could give was "Do not stay alone for any moment." Because according to them, this person had bad intentions towards her for the fact that he is declared socialist and tried to put her by force into the car and threatened her with a knife.

The student Lizabeta Pllumaj did so until she finished the high school "Don Bosco". But she was continuously threatened by anonymous phone calls on her mobile number, too. She hoped that someday these threatens will have an end, but they got worse. On October 20, 2015 in the village Tamara of Great Highland, after she bought some food for her family, in the middle of the village, a car stops nearby and someone from the car asked her: "Are you Lizabeta?". Poor girls innocently said, "Yes, I am."

- Ah, you are the supporter of the Democratic Party, sooner or later you will be ours, and support the Socialist Party, too.

The girl was terrorized because she didn't know these people and tried to leave, but suddenly the man who spoke from the car, got out of the car and exerted physical violence on her, then when he saw that people were approaching, he shot twice by gunfire in the air and hit her so hard with his fist, leaving her unconscious in the middle of the village Tamara of Great Highland. The villagers heard him saying: "I will come again; you cannot escape from us", make us think that this case is a continuation of that threatens in Shkodra, when she went at the high school "Don Bosco".

Tamara villagers are already aware of these threats and quite terrorized, too. They associate these actions with the aim that someone intends to rob this girl and trafficking her for prostitution, as this has happened in thousands of cases in the recent years.

**The Editorial Office**

# Kosovë: Qeveria duhet të ikë, që populli të mbet

Kosova, po ballafaqohet me krizën më të madhe ekonomike dhe sociale prej përfundimit të luftës deri më sot. Akumulimi i problemeve për 15 vite me radhë si papunësia e lartë, varfëria e skajshme, mungesa e perspektivës, janë shkaktarët kryesorë që kanë bërë që mijëra qytetarë të Kosovës të largohen nga vendi. Arsye tjetër e largimit të qytetarëve është humbja e besimit tek qeveria e krijuar me 9 dhjetor.

Lidhur me këtë çështje, Lëvizja VETËVENDOSJE! sot organizoi një aksion simbolik pranë Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku vendosi një autobus brenda të cilit shiheshin politikanët, të cilët duhet të largohen nga vendi, për t'iu kthyer shpresa qytetarëve të Republikës. "Është interesant të përmendet fakti që derisa qytetarët prisnin ndryshimin përmes krijimit të një qeverie pa PDK-në numri i të larguarve nga Kosova ishte shumë i vogël. Të dhënat zyrtare për azil në Austri thonë se në muajin qershor të vitit 2014 në atë shtet kërkuan azil 40 qytetarë nga Kosova, në muajin korrik 41, ndërsa në dhjetor, menjëherë pas themelimit të qeverisë, ky numër u shtua në 784. Vetëm në Gjermani deri më 31 dhjetor, sipas të dhënave zyrtare gjermane, kanë kërkuar azil 6.908 qytetarë nga Kosova", tha para



mediave deputeti i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Faton Topalli, duke shtuar se mosveprimi i Qeverisë përballë kësaj situate lë të nënkuptohet se pushtetarët përmes ikjes së qytetarëve po tentojnë ta sigurojnë paqen sociale në Kosovë.

"Qeveria po harron se në Kosovë janë të gjithë të varfër. Pra, jo vetëm 121.000 qytetarët që jetojnë me nga 63 cent ne ditë, jo vetëm 90% e rinisë që janë të papunë, jo vetëm 90% e grave të papuna, jo vetëm pensionistët me nga 75 euro, por edhe ata 300.000 të punësuar që nuk arrijnë t'i mbulojnë shpenzimet e veta pa u zhytur në kredi. Këta 300.000 të punësuar, i kanë 450.000 kredi. Pra, mesatarisht secili nga ata e ka nga një kredi e gjysmë", theksoi Topalli.

Ne si Lëvizje VETËVENDOSJE! i patëm propozuar në Kuvend disa ndryshime në projektbuxhet që ndërlidheshin me ngritjen e mirëqenies së qytetarëve, përfshirë këtu edhe dyfishimin e buxhetit për ndihma sociale, por këto propozime u kundërshtuan ashpër nga partitë në pushtet dhe nuk u miratuan. "Masat emergjente që do duhej t'i merrte Qeveria për këtë çështje, nuk do duhej të ishin kërcënime të ndryshme e aksione policore, as thirrjet për të mos u larguar nga vendi, as shlyerja e borxheve të vjetra që nuk kanë ndikim në zbutjen e varfërisë dhe që as nuk mund t'i inkasojë me ligjet në fuqi, por do duhej të ndaheshin të paktën 30 milionë euro për punësimin e mbi 10 mijë qytetarëve. Meqë këta qeveritarë nuk kanë plan ekonomik, më e mira që do të mund të bënin është t'i hipin autobusit e të dalin jashtë vendit të kërkojën azil. Këta janë të vetmit që i plotësojnë kushtet për azil, sepse kur dalin jashtë vendit mund të thonë se për 15 vite me radhë i kemi bërë keq popullit tonë, e kemi vjedhur, ia kemi shitur pasuritë dhe në fund edhe po e rrahim. Sa më gjatë që të rrijë kjo qeveri, aq më vështirë do të jetë për qytetarët e Kosovës. Andaj, këta duhet të ikin, që populli të mbetet", tha në fund Topalli.

# Dokumenti i CIA-s; Berisha gati te sakrifikoje pavaresine e Kosoves per zgjedhjet e vitit 1996

Shtetet e Bashkuara dhe shërbimet e tyre inteligjente kanë qenë të shqetësuar për mundësinë e shfrytëzimit nga Sali Berisha të çështjes së Kosovës për përfitime politike të brendshme.



Në një dokument të 21 dhjetorit 1995, analizohen zhvillimet në rajon pas Marrëveshjes së Dejtonit, që qetësoi një pjesë të Ballkanit.

Raporti i CIA-s shprehet se Marrëveshja e Dejtonit ka galvanizuar edhe shqiptarët e Kosovës për të ndryshuar statusin e tyre.

Në një kapitull të veçantë, raporti i grupit të posaçëm për Ballkanin trajton edhe rolin e Shqipërisë, duke u fokusuar te sjellja dhe ndikimi i Presidentit të kohës, Sali Berisha.

Si drejtues i shtetit shqiptar, raporti i inteligjencës nënvizon se Berisha do të ketë një rol parësor për të ruajtur stabilitetin në rajonin e Ballkanit.

Në komunikimin e tij me diplomatët amerikanë, Berisha është përpjekur të fuqizojë rolin e liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova, ndaj të cilit kishin nisur presionet e brendshme për një ashpërsim të linjës së vepimit.

"Berisha, me shumë të ngjarë duke njohur dobësinë e pozicionit negociues për shqiptarët etnikë, vazhdon të insistojë që Rugova të ndalë thirrjen për pavarësi dhe u ka thënë diplomatëve amerikanë se ai beson që fillimi i negociatave do ta ndihmojë Rugovën t'u shmanget presioneve nga shumë liderë aktivistë të shqiptarëve kosovarë", thuhet në dokumentin amerikan. Megjithatë, në dokumentin e inteligjencës amerikane, bie në sy edhe shqetësimi se Presidenti shqiptar mund të "rrëshqiste" edhe vetë në kursin e nacionalizmit, për shkak të zhvillimeve të brendshme politike, raporton "Shekulli".

Në momentin e përpilimit të raportit, Shqipëria ndodhej vetëm 5 muaj larg zgjedhjeve të shumëdebatuara të 26 majit 1996 dhe tensioni politik në vend po kapte majat. "Një sfidë politike nga Partia Socialiste – ish-komunistët – në zgjedhjet parlamentare pranverën e ardhshme mund ta shtyjnë Berishën të ndjekë një linjë më të ashpër në çështjet rajonale të shqiptarëve etnikë.

Ai gjithashtu mund të përdorë kartën nacionaliste për të fituar mbështetje nga partitë e vogla të djathta", vlerësojnë ekspertët e inteligjencës, të cilët kanë ndërtuar edhe një hartë të problematikës së Ballkanit.

Pjesa e dokumentit të shërbimit sekret amerikan, ku flitet për lëvizjet e Berishës

"Presidenti shqiptar Berisha do të luajë një rol drejtues, duke u përpjekur të balancojë përpjekjet për të përmirësuar gjendjen e minoritetit të madh etnikshqiptar në Serbi dhe Maqedoni, me përpjekje për të nxitur stabilitetin rajonal.

Megjithatë, Tirana u ka bërë jehonë kërkesave të shqiptarëve kosovarë për një vëmendje ndërkombëtare në Kosovë, duke u thënë diplomatëve amerikane në dhjetorin e shkuar se një dështim për futur në rrugën e zgjidhjes problemin e Kosovës do të çojë në një të ardhme të paqartë në Ballkan. – Berisha thuhet se u deklaroi diplomatëve amerikane që Marrëveshja e Dejtonit dhe një moderim i perceptuar në politikën e Beogradit kanë përmirësuar shanset për të ndjekur një zgjidhje për Kosovën. Ai u tha diplomatëve se Shtetet e Bashkuara duhet të marrin drejtimin për të ndihmuar të zgjidhet bllokimi në Kosovë, duke ndjekur vendosjen e trupave të NATO-s në Bosnje. – Berisha, me shumë të ngjarë duke njohur dobësinë e pozicionit negociues për shqiptarët etnikë, vazhdon të insistojë që Rugova të ndalë thirrjen për pavarësi dhe u ka thënë diplomatëve amerikanë se ai beson që fillimi i negociatave do ta ndihmojë Rugovën t'u shmanget presioneve nga shumë liderë aktivistë të shqiptarëve kosovarë. – Një sfidë politike nga Partia Socialiste – ish-komunistët – në zgjedhjet parlamentare pranverën e ardhshme mund ta shtyjnë Berishën të ndjekë një linjë më të ashpër në çështjet rajonale të shqiptarëve etnikë. Ai gjithashtu mund të përdorë kartën nacionaliste për të fituar mbështetje nga partitë e vogla të djathta".

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Rozafa gruaja e murosur

**Nga Arben Çokaj**



Rozafa është zanafilla e një qyteti të lashtë e legjendar. Gjithçka fillon me një legjendë, gjithçka vazhdon si në legjendë. Rozafa ishte aty, para se Krishti të lindte, ajo është aty edhe sot.

Për ata që e njohin legjendën e Rozafës, e kanë të qartë se në muret e saj prehet një trup i gjallë nëne.

Gruaja 'Rozafë' lutet që t'ia lënë njërin gji jashtë, për të ushqyer me qumësht djalin e saj të vogël. Me trupin e saj, Rozafa i dha jetë një fëmije, me sinqeritetin dhe vetëflijimin e saj, ajo i dha jetë një qyteti. Mbi të u ngrit një kala, tre vëllezërit e legjendës gjetën mirëkuptim mbi murosjen e kësaj gruaje. Si gjithmonë, dikush flijohet që diçka më e madhe të jetojë. Dhe Shkodra jetoi në shekuj mbi flijimin legjendar.

Vetë historia njerëzore, në turbulencën e saj nënndërgjegjësore, ka provuar paarsyen e vet paradoksale:

**DIÇKA E SHENJTË JEPET, DIÇKA E SHENJTË FITOHET!**

Jeta është e shenjtë. Dhe brezat që vijnë, gëzojnë mbi atë që u shua. Rozafa, kjo grua naive, mund të kishte vdekur si të gjitha të tjerat – e harruar, por ajo vdiq, pa e ditur as vetë, për të jetuar si *legjendë*. Ky paradoks i arsyes njerëzore na çon tek një fillim: Plaku orakull, u tregon vëllezërve se duhet të murosin njërën nga gratë, që muri të qëndrojë.



A mos ndoshta ky mësim filozofik i orakullit, kjo simbolikë unike e veprimit, don të thotë, se kur ti humbet diçka të shtrenjtë, fillon dhe e vlerëson atë, që ti ndërton mbi këtë humbje?… Dhe kjo ndodh krejt natyrshëm në kohën e Rozafës, gruas që u muros për të dhënë jetë. Ajo u muros se thoshte orakulli, u martirizua për hir të zakonit, dhe kjo përbën forcën filozofike të vetë legjendës: *flijimin si domosdoshmëri të padiskutueshme*.

Por a janë të gatshëm vallë, të gjithë njerëzit të flijojnë? Jo, por në të vërtetë, po! Secili nga ne humbet diçka, dikush më shumë, dikush më pak, pa dëshirën tonë, pa vetëdijen tonë. Kjo ndodh po aq natyrshëm, sa ç'ndodhi me Rozafën. Por humbjet tona janë të vogla, individuale, ndërkohë që humbja e Rozafës u bë për hir të interesave globalë: ndërtimit të një muri mbrojtës për qytetin e Shkodrës.

